

DHJETË VJET MË PARË, 24 MARS 1999 KUR NXIRRNIM NUMRIN E PARË, NATO NISI LUFTËN PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS



Nga Flori SLATINA

Është një koincidençë e bukur, të cilën as që do ta mendonim dhjetë vjet më parë, tek sa bëheshim gati dhe prisnim me padurim numrin e parë të gazetës "Mokra". Ajo datë, 24 marsi, kur gazeta po shtypej për të nesërmen, NATO nisi sulmin përfundimtar mbi serbët pushtues të Millosheviçit, për t'i sjellë lirinë endërruar një populli të rraskapitur nga dhuna e egër dhe e paparë, shekullorë serbe. Në gazetën "Mokra", mes Mokrës dhe ngjarjeve të Kosovës, ne hoqëm paralele dhe gjetëm ngjashmëri në udhën historike. Edhe pse një gazetë lokale, ne nuk mund të rrinim indiferentë, kur një pjesë e kombit tonë mbulohej në gjak e priste agun e lirisë, e cila erdhi në limitin e shekullit XX. Në këtë pranverë të dhjetë, kur po përgatitemi të festojmë dhjetëvjetorin e gazetës, në vendlinjen tonë, (tashmë jemi më shumë se dhjetë vjet më parë), u genda për herë të parë në Prishtinë, në Kosovën e lirë, tashmë shtet i pavarur, pjesë e pandashme e Evropës së qytetëruar.

Udhëtimet jashtë vendit gjithmonë janë të bukura, por janë të mrekullueshme, edhe më të bukura e të paharuarura kur udhëton në një vend ku ndihesh si në shëtinë tënde, kur dëgjon gjuhën tënde, kur shikon dashurinë dhe respektin e njerëzve, vëllezërve të një gjaku, rrace e gjuhe.

Prishtina është një qytet i bukur, ku në çdo pjesë të saj ndihesh krenar për qëndresën, për atë që ata e kanë arritur me aq mund e sakrificë, ndër shekuj. Kudo ka simbole kombëtare, flamuj kombëtarë, në qendër monumenti i Skënderbeut, i Nënë Terezës, i legjendarit Adem Jashari kujtimi dhe lavdia e dhjetëra e qindra luftëtarëve të UÇK-së, figura madhështore e Ibrahim Rugovës, veshjet tradicionale, gjithçka është impresionuese dhe e veçantë. Kjo rastësi, në këtë dhjetëvjetor të gazetës, është vërtet e bukur dhe mbresëlënëse, një kujtim që nuk përsëritet shpesh por të shpresojmë që përvjetorë të tjera të na gjejnë së bashku në Evropën e Bashkuar, si pjesë natyrale dhe e domosdoshme e saj.

Pranvera e dhjetë



KRYEPARLAMENTARJA JOZEFINA TOPALLI TAKON DHE URON NXËNËSIT E MËSUESIT E SHKOLLËS SË RRAJCËS, ME RASTIN E 7 MARSIT, FESTËS SË MËSUESIT

MOKRA PËRBËN NJË PELLG TË KUFIZUAR QARTË

Nga Zenun FERRO

Mokra ka qënë banuar që në periudhat e hershme të historisë. Për këtë flasin shumë dëshmi; vend-


Thirrja e Gjakut

Nga Istref HAXHILLARI

ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I FSHATIT HOMESH

Nga Ramadan GJATA

Homeshi nga pozita gjeografike ndodhet rreth 20 km në veri-perëndim të qy-



MBRESA TË PËRTËRIRA

I pazhgënjyer me vendlindjen

Nga Haki BALLIU

Mbas botimit të ndonjë shkrimi apo libri, shpesh rri e kërkon njerëzit e mirë, për të cilët ndihesh ngushtë pse i ke lënë jashtë rrëfimit kur është dashur të shkruash. Kësaj here malli më zbrat poshtë në qendrën administrative të Proptishtit të vjetër kur pata filluar punë si dyqanxhi në koopera-



tivën e konsumit. Ishin fillimvitet 50 të shekullit të kaluar dhe shumë ngjarje më kanë dalë nga kujtesa. Megjithatë para syve më shfaqet ajo qyteza e lokalitetit që ngrihej përfund fushës, buzë xhadesë e sipër lumit

NË LABIRINTHET E MONUMENTEVE KULTURORE, HISTORIKE TË PËRBOTSHME

Nga Llazi TONA



FALENDERIM!

REDAKSIA E GAZETËS "MOKRA" FALENDERON THELLËSISHT NGA ZEMRA Z.ZABIT ÇUKU, PËR SPONSORIZIMIN E KËTIJ NUMRI

MBRESA TË PËRTËRIRA

I pazhgënjyer me vendlindjen



Nga Haki BALLIU

1. PROPTISHTI I VJETËR

Mbas botimit të ndonjë shkrimi apo libri, shpesh rri e kërkon njerëzit e mirë, për të cilët ndihesh ngushtë pse i ke lënë jashtë rrëfimit kur është dashur të shkruash. Kësaj here malli më zbrat poshtë në qendrën administrative të Proptishtit të vjetër kur pata filluar punë si dyqanxhi në kooperativën e konsumit. Ishin fillimvitet 50 të shekullit të kaluar dhe shumë ngjarje më kanë dalë nga kujtesa. Megjithatë para syve më shfaqet ajo qyteza e lokalitetit që ngrihej përfund fushës, buzë xhadesë e sipër lumit Shkumbini. Pikërisht aty ka gjasa që Aleksandri i Maqedonisë, më pas konsulli romak Sulpic, të kenë fushuar kampin ushtarak për pushtimin e Pelionit. Me sa kujtohem qyteza kishte në prehrin e saj 6-7 ndërtesa një katëshe: Zyrat e komitetit, policia, infermjeria, dyqanet, depot e grumbullimit të drithërave dhe shkolla 7-vjeçare. Ishin dhe baraket e vogla, berberhane që vazhdon të ruaj anekdotën "Lagu se të rruan Bektashi" dhe shtëpia e esmerkës Tana. Në distancë lokaliteti i vjetër komunist bije të ketë qenë afër me komunën e sotme demokratike por në kohë jemi shumë larg. Qysh atëherë ka rrjedhur një jetë e tërë. Te unë shkëlqimi i rinisë është tretur si vetë koha, por jo dhe mbresat. Atëherë m'u dha mundësia të punoj në pesë fshata: Selcë, Proptisht, Slabinjë, Velçan, dhe Debrovë. Pata fatin të njoh nëpunës lokalë të shquar dhe burra trima e fisnikë, disa prej të cilëve regjimi i fundosi në vend t'i ngrinte. Më mirë se këta nuk harroi fshatarët hallexhi që edhe pse shinin për të blerë, kuleta u mbetej bosh. Sigurisht kam njohur bashkëmoshatarëve, djem e vajza, me boten e mbyllur, me jetën e izoluar që i trembeshin fatit. Ndërkohë unë që fillova punë qysh 14 vjeç e 9 muaj, më dukej sikur kisha thyer me grusht kafazin e monotonisë.

Gjithsesi isha tepër i ri për të qenë i vëmendshëm ndaj jetës së të tjerëve. Tani që dielli është në të perënduar po angazhoj shpirtin të rikujtoj ndonjë ngjarje ashtu siç e doja për kohën...

2. URA ME NJË TRA

Më duhej që lumin ta hedh pa u lagur. Me vete kisha një torbë plot me kartëmonedha. Dhe paraja si baruti ruhen të thata. Sasia e tyre ishte xhiroja disa ditore e dyqaneve të Proptishtit e mbledhur mokrarëve të skamur nga blerja e mallrave industriale. Me urdhër të shefit tim, Faik Kapri isha nisur t'i dredhja në arkën e konsumit në Pogradec. Mirëpo një ditë më parë urën e kishte rrëmbyer Shkumbini. Prej saj rezistonte mundimshëm vetëm një tra. Teksa vështroja kërcimin e lumit poshtë, më duhej të luaj rolin e pelivanit mbi tel. Shkumbini i bekuar shpesh kthehej kështu i babëzitur që hante njerëz si një front lufte më vete. Vite më parë kishte rrëmbyer ndërtesën e mullirit të Shaban Fetës bashkë me dy djem të ri që u ndodhën brenda, njëri prej të cilëve ishte djali i tim vëllai, Skënderi. Sot, pas 55 vite të shkauara, kam parë se bishtit të urës i është afruar tinëz rruga automobilistike. Ndërsa ura është po ajo si një reliqë e vjetër jashtë kohe. Mbase shpejt do të shohim aty një prerje shiriti, pse jo edhe Egnatia e kthyer në autostradë. Gjithsesi mua më duhet të kthehem mbi një gjysmë shekulli pas. Atë ditë sapo vara torbën e parave krahu qafë m'u bë sikur mbaja varur varfërinë e mokrarëve.

Teksa po ecja mbi tra me shikim të trembur, dëgjova zërin e mullëxhiut plak që vinte në anën tjetër të urës: "Mos vështro poshtë, se të merren mentë!"

Kur dola matanë dikush më thërriste nga pas. Ishte polici Haki Bufi, i cili me lëvizjen e kraut të gjatë bënte shenjë të kthehesha. Ashtu bëra. Pas disa minutave ndodhesha te i plotfuqishmi i lokalitetit.

- Ke bukë me vete? - pyeti...

- Jo, i thashë.

- Domethënë po të kërkonin bukë diversantët në malin e Jamës, do t'u dorëzoje paratë e shtetit, apo jo?

Unë heshta si i zënë rob. Toni i ngritur i burrit me uniformë trembte edhe ariun e Ponikut. E lashë policin dhe shkova të njoftoj shefin tim, Faik Kaprin, që më kishte ngarkuar misionin e "rrezikshëm" të postierit.

Faik Kapri ishte nëpunësi, me sjellje të qytetëruara, me mendime të thella, një zotëri i vëtrëtë. Qëndrimin e tij burrëror e kishte të përcaktuar një herë e mirë: korrekt në zyrën e shtetit, këmbëkryq në tryezën e rakisë. Në se në ato vite do të më thoshin zgjidh një udhëheqës shpirtëror, Faik Kaprin do të zgjidhja. Ai nuk është më. I lindur në vitin 1905, ndërroi jetë në vitin 1980. Por unë e shoh ashtu me ballin lart, flokët e zeza krehur sipër, gjithnjë në ecje, me çizme të gjata apo këpucë të trasha, me një nagant në brez dhe pushkën gjermane ne sup. Kështu ruante përjetë-



sisht hijen e luftëtarit të lirisë. Ndërsa ndodhesha përpara tij uroja qiellin që ai më kishte pranuar në punë si shitës ambulant. Kur e njoftova për ç'arsye më kishte ndaluar i plotfuqishmi, më tërhoqi veshin që herë tjetër të mos vendosja "karrocën përpara kalit". Hymë në zyrën e tij shitësit e tjerë si Faik Isufi, Brajam Belegu e Feim Leka, që të tre mirëbërësit e mi, që të tre pjesëmarrës në luftë, që të tre do të shumëzoheshin me zero. Ata e njoftuan shefin se do të vinte një kamijon të ngarkonte arra për në Pogradec, me të cilin do të nisesha edhe unë. Ndërsa kthimin do ta bëja në këmbë nga mali i Jamës.

Po të kapën diversantët, bëju të fala nga Faik Kapri dhe të lëshojmë, -qeshën ata. E kuptoja shakanë e tyre, ama në rast "rreziku" emrin e shefit do të përdorja vërtet. Makina e mbuluar me fletë cadre nuk vonoi të vintë që nga Pogradeci. Dilo Kumia i Selcës zbriste që nga Stravaj me tri mushka ngarkuar me arra. Prej natyre Dila ishte gjithë gjallëri. Përveçse burrë fisnik, me trup fin, mustaqet e zeza spicë, sytë plot dritë kishte të vetin edhe humorin e hollë. Këto cilësi apo virtute më pas

duket se ia vendosën në dosje si një akuzë më shumë për të rritur vitet e burgut.

Po le ta kapërcejmë për momentin endërrën e keqe se na duhet të vazhdojmë rrëfimin.

Të gjashtë thasët me arra i ngarkuam në makinë. Ndërkohë arriti një kapiten i Degës së Brendëshme të Pogradecit. I armatosur me automatik, pistoletë e bomba, ai kishte marrë nën arrest një vajzë nga Velçani. Çupëza ishte bjondinëz, bojë ndinëz me sytë dhe fytyrën gjithë shkëlqim. Ajo mbante fustan kur bashkëmoshatarët ende visheshin me çitjana dhe flokët lëshuar kur të tjerat vajza nuk kishin hequr shamitë e kokës.

Tiparet e saj i pashë me një vështrim të shpejtë. Pastaj hypa në kamijon. Përveç xhiros javore në të holla më duhej të shoqëroja edhe arrat e Dilo Kumes. Atë çast kapiteni u hoq më njanë të fliste me kryetarin e lokalitetit Maliq Lufon. Ky burrë deri në vdekje i pa lodhur, i ligjit dhe drejtësisë, korrektësinë në detyrë na e përcolli me mesazhin "Këtu ka ligj, s'ka xha Maliq". Aso kohe ai nuk do të besonte se pas një gjysmë shekulli autorsia e mesazhit të tij do të përvetsohej shëmtueshëm nga

dhu-nuesit e ligjit me shprehjen "Ka ligj, po ka dhe Maliq". Nesje, atë ditë Maliqi ynë mbase bisedonte me njeriun e policisë për të ndryshuar fatin e vajzës së së arrestuar. Po kjo nuk ndodhi. Atëhere e mjera vajzë u afua tek spondi i makinës, mirpo e kishte të vështirë të ngjitej. "Jepi dorën, o çuno"- më tha kapiteni e sakaq hypi në kabinë pranë shoferit. Prej atij çasti unë "mëktatarja" u bëmë bashkëudhëtarë gjer në Pogradec. Aty u ndamë. Makina ndaloi përpara Degës Brendëshme. Pikërisht aty ajo zbriti duke më përshëndetur me lëvizjen e buzëve ngjyrë trandafil. Pastaj e bindur shkoi pas kapitenit si delja pas ujkut. Porta e policisë u hap e u mbyll me kërcitje të egër dhëmbësh metalik. Arsyen pse Velçanaken e bukur e mbyllën në qeli, e mësova qysh të nesërmen. Për gjithë natën thashethemet kishin prekur Mokrën e Pogradecin si epidemia e gripit të zi.

Gjer këtu dhe lexuesin më duhet ta lë në errësirë. Vikëtimat e kohës së perënduar shpresoj të jetojë pleqërinë e saj të lumtur dhe s'dua ta lëndoj pas kaq viteve të shkuarara. Po ku ta dish ç'mund të na teket? Mbase historisë së saj do ti kthehem kur vijmi i këtij shkrimi do të na shpjerë në Velçanin e madh.

3. DIVERSION ME FJALËN "DIVERSANT"

Teksa kthehesha nga Pogradeci nëpër pyllin e Jamës, paralajmërimi i policisë për gjëmën që mund të më ndodhte me diversantët, m'u kujtua vetëm kur më preu rrugën një lepur i trembur sa dhe unë. Deri atë ditë fenomeni diversant qëndronte paksa jashtë vigjilencës sime, thjeshtë sepse njëri nga të arratisurit mokrar dikur më kishte shpëtuar jetën duke kthyer vdekjen nga rruga...

(vijon)

DATAT E PROVIMEVE PËR MATURAT SHETËRORE DHE PROVIMET E LIRIMIT PËR NXËNËSIT E ARSIMIT 9-VJEÇAR

Nga data 22 maj dita e fundit e shkollës, deri 2 qershor, datë kur do të jepet provimi i parë me detyrim në lëndën e letërsisë dhe gjuhës shqipe, maturantët do të jene nën këshillimin e vazhdueshëm të mësuesëve të lëndës.

Më pas koha e këshillimit do të ndalet dhe gjithçka do të t'u lërë kohën provimeve të Maturës Shtetërore 2009, hapi i fundit drejt përfundimit me sukses të arsimit të mesëm. Gjithçka është vendosur në udhëzimin më të fundit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencave, ku në ndryshim nga viti i kaluar vihet re një afrim i datave të provimit të Maturës Shtetërore. Burime pranë dikasterit të arsimit deklarojnë se afrimi i datave të provimeve të Maturës Shtetërore është bërë me qëllim, për të mos krijuar

përplasje me provimet e lirimit në arsimin 9 vjeçar, ndër kohë që është marrë parasysh në këtë rast edhe edhe zhvillimi i zgjedhjeve elektorale në vend, më 28 qershor 2009. Provimet e maturës Shtetërore, 2009 do të jenë të ndara në vartësi të profilit të shkollës së mesme. Periudha e zhvillimit të sezionit të parë të parë të provimeve përfundimtare, do të jetë për provimet e Maturës Shtetërore periudha kohore nga data 01 qershor 2009 deri 10 korrik 2009, ndërsa për provimet përfundimtare në shkollat profesionale 3+2-vjeçare, periudha kohore nga 22 qershor 2009 deri 01 korrik 2009. Të parët që do të nënshtrohen provimit do të jenë maturantët në shkollat e mesme pedagogjike për minoritetin në seksionet dy gjuhëshe (Profil shoqëror dhe natyror), si edhe ata në shkollat e mesme artistike dhe sportive.

PROVIMET E LIRIMIT NXËNËSIT E ARSIMIT 9-VJEÇAR, PROVIMI I PARË MË 13 QERSHOR 2009.

Viti shkollor për nxënësit që përfundojnë ciklin e arsimit bazë 9-vjeçar, do të mbyllet më datë 5 qershor 2009, ndërkohë që periudha kohore e zhvillimit të sezionit të parë të provimeve do të jetë data 6-27 qershor 2009. Nxënësit të cilët përfundojnë klasën e 9-të do të japin këtë vit dy provime lirimi përkatësisht gjuhën shqipe dhe lexim letrar, si dhe matematikë. Provimi i parë që ata do të shlyejnë është gjuha shqipe dhe lexim letrar më datë 13 qershor 2009, ndërsa një javë më pas ata do të ulen serish në bankë për të dhënë provimin e dytë me shkrim në lëndën e matematikës.



Nga Zenun FERO

Mokra ka qënë banuar që në periudhat e hershme të historisë. Për këtë flasin shumë dëshmi; vendbanime, objekte të ndryshme e materiale arkeologjike.

Tre fiset ilire, që kanë banuar në këto anë, enkelejtë, në jug të liqeneve Lyhniid (Ohrit dhe Prespës), që shtriheshin edhe në fushën e Korçës dhe atë të Devollit, kandavëve të vendosur në Mokër, por që zgjeroheshin gjithashtu në Luginën e Mesme të Shkumbinit e në Çermenikë si dhe dasaretëve në krahinën e Gorës, që vazhdonin në Opar, Skrapar e më gjërë. (*Historia e Shqipërisë, Vëllimi i I-rë, botim i vitit 1959*).

Në vitin 335 para krishtit, Aleksandri i ra befasisht ushtrisë së klitit dhe Glaukias, e cila pësoi humbje, lëshoi kodrat dhe u tërhoq. Kliti, duke ndërë rrezikun që i kanosej me largimin e taulantëve, u tërhoq në malet e Mokrës. (*Cituar në "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë"*).

Pas një rezistence të madhe dhe tri luftime iliro-romake, një sërë luftërash maqedonia-romake, greko-romake, fiset ilire, përfshirë enkelejtë, kandavët e dasaretët, ranë nën sundimin romak në vitin 200 para krishtit. Maqedonët hoqën dorë nga tokat që kishin pushtuar në Iliri, midis të cilëve edhe nga krahinat e dasaretëve e kandavëve. Të gjitha viset rreth liqeneve të Ohrit, Prespës, të pjesës juglindore, të banuara nga enkelejtë, lynkestët, kandavët, dasaretët Ohrit, dhe kishte organet e veta të administrative. (*Cituar në revistën "Iliria,, nr 1, viti 1986"*).

Në ndarje administrative e ushtarake të bërë nga Perandori Theodhosi (379-395), tek Ohri bënin pjesë edhe fiset e enkelejve, kondavëve e dasaretëve. Me ndarjen e perandorisë së Romës në vitin 395, fiset ilire, përfshirë ato të enkelejve, kandavëve dhe dasaretëve, mbetën nën Bizantin. Pas kësaj kohe ato do të përmenden në histori, jo më si vise më vete, por si pjesë përbërse të Bizantit.

Një rrezik i madh për Mokër në vitet 400, qenë dyndjet e vizigatëve, gotëve, hanëve, astrogotëve, avarëve, të cilët duke zbritur nga viset veriore duke ardhur nga Maqedonia kaluan nëpër Luginën e Shkumbinit, rrugës Egnatia. Ata plaçkitën, e shkatërruan gjithçka që gjetën përpara. Për këtë është dëshmitar Iliriku..., ku çdo gjë u zhduk, përveç qiellit e tokës, gjëmbave që rriten dhe pyjeve të dendura. (*Euseb-Hieronimi, "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë,, faqe 354"*).

Në vitin 479, gotët e Lindjes, duke lëvizur nga Heraklea nëpër Lihnid (Ohrid) për perëndim për detin Adriatik, qenë sulmuar befasisht nga një ardhje rameje

MOKRA PËRBËN NJË PELLG TË KUFIZUAR QARTË

pranë Kandavisë. (*Mokër*). (*Tomo Tomoski gazeta "Mokra,, Nr 11 dhjetor 1999.*)

Pelioni ishte vendbanimi më i madh në krahinën e Mokrës dhe gjatë tërë luginës së Shkumbinit. Kjo krahinë që rrethohet nga amfiteatri gjigand i maleve të Polisit, Gemthit, Kamjes, Jamës dhe Rrajcës përbën një pellg gjeografik të kufizuar qartë. Prej shpateve të tyre zbresin drejt shtratit të ngushtë të Shkumbinit, që e prët më dysh pellgun, vargje kodrash, të përshtatëshme për zhvillimin e bujqësisë. Përveç ultësirës së Domosdovës, krahina nuk ka fushë tjetër. (*Neritan Ceka "Qyteti Ilir Pranë Selcës së Poshtme,, Tiranë, 1985, faqe 8"*)

Në gjysmën e parë të shekullit 6-të në Iliri filluan të vijnë fiset slave, të cilat kanë kaluar në Luginën e Shkumbinit, Mokër. Nga toponime në gjuhën sllave, Mokër (vend i njomë me ujra). Toponimet dhe fjalët sllave, që hynë në Mokër, i takojnë grupit juglindor të sllavëve, nga i cili më pas lindi populli bullgar.

Nevojat e përbashkëta ekonomike dhe të mbrojtjes nxitën procesin e bashkimit të fshatarëve në bashkime ekonomike gjeografike, etnografike, që dokumentohen në shekullin 9-të me emrat; "Zhupa, dheu. Mund të përmendim zhupa e Koplikiu, dheu i Mokrës, i Devollit e tjerë. Ilirët tashmë duhen kërkuar si banorë që mbajnë emra të rinj



territorialë, jo me fisnore. (*Historia e Popullit Shqiptar, Për vitin e Katërt të Shkollës së mesme të Përgjithshme,, Tiranë 1999, faqe 25*).

Në shekullin e 9-të krahina e Mokrës, që ndodhej nën sundimin bizantin, u shtri shteti bullgar. Mbreti Simeon (893-927) e ktheu shtetin bullgar në perandori dhe shpalli veten Car të bullgarisë dhe bizantinëve. U pushtua Ohri, Devolli, Mokra e tjerë, në çerekun e fundit të shekullit 10-të, nën Samuilin, qendra e mbretërisë bullgare, u bënë Prespa dhe më pas Ohri.

Me vdekjen e Samoilit në vitin 1014, në fuqi erdhi Jovan Vladislav, lufrat u ndezën dhe në vitin 1018 u vra dhe sundimtari i fundit. Ohri ra nën pushtimin bizantin. Mbetet e hapur çështja si shkrimtari bizant Ana Komnena, ka arritur deri tek emri Mokrës. Me një herë duhet të tregohet se ajo fjalë (emër) kish qënë në përdorim në kohën e Niqifor Brienji. Bashkohësi i tij Teofilakt Ohirindski, në letrën që i kishin dërguar tek magjistari Jovan Pantenhnu, rreth viteve 1107-1108 e përmend këtë emër si toponim me

MOKRA SHTRIHET NË TOSKËRI

Toskëria është emërtimi i përgjithshëm për krahinat etnografike të Shqipërisë jugore, që shtrihen nga lumi Shkumbin deri në gjirin e Artës në jug, nga vargu i maleve Gramoz në lindje, deri në brigjet e detit Adriatik e Jon, në perëndim. Dëshmohet për herë të parë në dokumentat historike të shekullit të XV.

Mendohet se vjen nga emri i një fisi më të hershëm, i cili banonte diku në malet në mes të rrjedhjes së sipërme të lumenjëve Devoll e Vjosë. Gjatë shekullit të XVI-XVII, ai u bë strumbullari i disa fiseve e grupeve të vogla popullsie, që banonin rreth tij si, Dëshnica, Dangëllia, Shqeria, Opari Skrapari, Vërça, Shpati, Mokra e tjera, dhe me ta formoi një bashkësi ekonomiko-shoqërore, formoi edhe një njësi kulturore të përbashkët. E drejta kanunore shkoi drejt zhdukjes, e në vend të saj u gërshetuan disa norma tradicionale me normat e së drejtës kanonike e të sherihatit. Forma e fshatrave ishte kryesisht me shtëpi të grumbulluara. Zotëronin ndërtesat e mëdha e kryesisht të ndërtruara me gur e dru, mbeturinat e të cilave gjenden në rrethin e Gramshit, në Moglicë, Opar etj. Në veshje erdhi duke u përgjithshuar këmisha dhe guna.

Me zhvillimin ekonomik edhe lëvizjet e popullsisë duke u nisur nga shekulli i XVII grupe toskësh e labërisht u vendosën në Myzeqe; grupe toskësh kaluan Vjosën e u vendosën në Labëri e grupe labërisht u vendosën në Toskëri, si përsëmbull në Tomorriçë, Skrapar, Kolonjë, etj.

Nga fundi i shekullit të XVIII, rreth pashallëkut të Janinës të Ali Pashë Tepelenës, u bë përqëndrimi politik i Shqipërisë së Jugut në një njësi ekonomi shoqërore dhe politike, ku mori pjesë Myzeqja, Labëria, Çamëria dhe Toskëria e cila i dha edhe emrin. Edhe të folmet e kësaj treve morën emërtimin e përgjithshëm toskërishte.

Në marrëdhëniet shoqërore, me pak përjashtime, si në Labëri e Myzeqe, e drejta kanunore u lëshoi vendin përfundimisht normave të së drejtës kanonike e të

sherihatit. Në banesa mbizotëroi tipi i shtëpisë i quajtur "dollmali Elbasani,, dhe ai i shtëpisë dy dhomëshe, me një korridor në mes. Shpesh të dy tipat paraqiten me një kat të ngritur në lartësi. Në veshjen e brendshme, filloj ta përdorë si veshje të sipërme.

Në muzikën popullore mbizotëroi polifonia, kurse në vallet ajo në grupet valltarësh të udhëhequr nga një korife. Gjatë shekullit të XIX me zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste dhe me hovin e Rilindjes Komëtare, dallimi ai Toskërisë nga Gegëria shkoi duke humbur rëndësinë. Sot emiri Toskëri ka mbetur si një nocion historik-etnografik.

GEGËRIA është emërtimi i përgjithshëm për krahinat etnografike të Shqipërisë së Mesme e Veriore, duke nisur nga krahu i djathtë të Shkumbinit, të folmet e të cilave përfshihen në dialektikën e veriut.

Me kuptimin më të ngushtë, Gegëria e mirfilltë (ose sipas emërtimit popullor "Malet e Gegëve") përfshinte krahinat nga Shkumbini e deri në lumenjtë e Veleshicës, malësisë së Lurës, Urakës dhe rrjedhjen e poshtëme të Matit. Në perëndim shkonte deri në bregdet, kurse në lindje, deri ku shtrihen historikisht shqiptarët.

Emri i banorëve gegë nuk është i përcatuar pre-razi. Disa nga bashkësitë e vogla që morën emrin "Nëntë malet e Gegëve" qenë: Mati, Matraneshi, Lura, Dibra, Malësia e Tiranës dhe e Krujës, Benda, Tomadhe, Kurbin, fusha e Arbërit, Çermenika e tje. Ky bashkim malesh gjeti shprehjen më konkrete në mesjetë, në principatën e Kastriotëve e cila ishte nën udhëheqjen e Skënderbeut. Me pushtimin osman, krahinat e vogla që bënin pjesë në gjë të saj, nuk mundën të ruanin më njësinë e mëparëshme. Megjithatë, ruajtën nga e kaluara disa tradita të përbashkëta të kulturës materiale e të folklorit, disa veçori dialektore e tje. Sigurisht edhe emrin e vjetër "Malet e Gegëve".

Shtrirja e termit Gegëri për të gjithë Veriun e Shqipërisë i takon kohës së re. **Zenun FERO**



fjalët që vijojnë: Rreth Ohrit gjithëçka është plot me frikë. Edhe rajoni i Mokrës është në rrethinët e Ohrit, i plaçkitur sklevër e grabitqarë renegatë,,

Një letër tjetër më parë në vitin 1094 qe dërguar deri tek episkopi i Vidinit, shkruan me urrejtje për qytetarët e Ohrit, duke i mbiqajtur me atë rast 'maloke Mokrane,,

Në 1347, prej më shumë se 9 shekuj mori fund sundimi i Bizantit, dhe filloi pushtimi serb. Ky pushtim nuk vazhdoi gjatë, në vitin 1355 perandoria serbe u shpërbë. Në këtë kohë feudalët shqiptarë bëhen të pavarur, duke krijuar zotërimi e principata më vete, si arianitëve në Mokër, Çermenikë dhe Shpat, e tjerë. Në shekullin e 14-të kur ushtritë osmane filluan të futen në tokat shqiptare, Mokra bashkë me Shpatin bënte pjesë në zotërimin e Aranitëve. (*Historia e Shqipërisë, Vëllimi i I-rë, botim i vitit 1959, faqe 246*).

Me pushtimin osman, u vendos regjimi feudal-ushtarak, u vendosën taksa të shumta e të rënda. Kjo solli pakënaqësi tek banorët, kështu filluan kryengritjet e fshatarëve në krye të cilave u vunë bujarë feudalë. Kryengritja e parë filloi në zotërimet e Aranitëve në verën e vitit 1432. Ajo u udhëhoq nga vetë Gjergj Araniti, osmanllinjte u thyen. Për këtë Sulltan Murati II nisi në drejtim të Shqipërisë, një ushtri në komandën e Ali Bej Evernazit në dimrin 1432-1433. Në ndeshjen me forcat shqiptare në afërsi të fshatit Bërzeshtë në Mokër.

Në vitin 1434 Sulltani, me komandant Sinan Pashën, mori një sulm të ri në drejtim të Mokrës, Çermenikës dhe Shpatit. Luftimet vazhduan deri në 1435, ku Gjergj Araniti u detyrua të tërhiqet.

Gjergj Araniti, si prijës i Mokrës, Shpatit e Çermenikës, në mars të vitit 1444 radhitet midis bujarëve shqiptarë që morën pjesë në Kuvendin e Lezhes, të organizuar nga Skënderbeu.

Në betejën që u zhvillua më 29 qershor të vitit 1444, në fushën e Mokrës (Torviollit), ushtria shqiptare e komanduar nga Skënderbeu i shkatoi ushtrisë osmane disfatë të plotë. Ishtë beteja e parë e ushtrisë shqiptare, nën drejtimin e Skënderbeut, me të drejtë Marin Barleti shprehet: "Atë ditë luanët kanë komanduar luanë,, (*Marin Barleti, "Historia e Skënderbeut,, Tiranë 1964, faqe 111*) Pas kësaj beteje, fushës së Torviollit, Sulltan Murati i II-të, i'a ndryshoi emrin, dhe ia vuri emrin turqisht "Fusha e Domosdovës,,.....

Studiuesi gjerman Bahinger thotë: "Po të mos ishte Skënderbeu, heroi kombëtar i shqiptarëve do të ishte Gjergj Araniti (Golemi), që në kujtesën e popullit njihet si Gjergj Golemi,, Nga dokumentat historike të vitit 1432-1436 Gjorg Golemi paraqitet si figura më e madhe ushtarake, e cila shkatërroi turqit në shumë beteja. Gjorg Golemi lidhet fuqishëm me Skënderbeun, dhe për këtë u bë martesa e Donikës, vajzës së Gjorg me Skënderbeun më 26 prill 1451, lidhje e cila i mbajti shqiptarët të bashkuar në luftë kundër trurqëve.

(vijon në faqen 6)



Nga Ramadan GJATA

Homeshi nga pozita gjeografike ndodhet rreth 20 km në veri-perëndim të qytetit të Pogradecit dhe si pjesë veri-lindore e Mokrës. Është vendosur në një luginë, që rrethohet nga kodra e male të larta nga 500-1500 metra të larta (Haishta e Gegës) ku sot është vendosur Antena e televizionit. Nga gojëdhënat e bisedat me historianë të ndryshëm emrat e fiseve që ekzistojnë si dhe toponimet sot të bëjnë të mendosh se është themeluar nga banorë të ardhur nga zonat veriore rreth fundit të shekullit të XIV dhe fillimit të shek. XV dhe emri i fshatit Homesh vjen nga latinishtja (Homes). Fiset që janë vendosur të parët kanë qenë Gjatat, Bizjonat, Pengut, Damet, Minkshat pak më vonë dhe Çollarët me besime të krishterizmit dhe kohë pas kohe disa nga fiset kanë ngritur edhe institucionet e kultit fetar si Bizgjanat, Pengut e Damot. Shkaqet që i kanë detyruar të vendosin në atë luginë mbrojtja nga invazionet e luftërave të kohës si dhe mbrojtja e besimeve fetare ky vend (Homeshi) ka shërbyer edhe si pikë grumbullimi nga pikëpamje strategjike, i forcave luftarake të Mokrës për t'u dalë para ushtrive turke që vinin nga Manastiri, Ohri e të futeshin në territorin shqiptar nga Qafë-Thana. Kjo konkretizohet edhe me trashëgiminë e folklorit mokrar brez pas brezi kur Gjergj Golemi i bën thirrje udhëheqësit të krahinës së Mokrës, Angjerinit, që luftëtarët e Mokrës të grumbullohen tek Gurët e gjete (Gurët Olies) pranë fshatit Homesh:

*"Gjergj Golemi na çon fjalë
Agjerini të na dalë
Me ata trima mokrarë.
Kush me këmbë e kush me kalë
Kush me thika, e kush me pallë
Të marrin rrugëgjënë përpyjetë
Të dalin te gurët e gjete".*

Po kështu ka shërbyer edhe si pikë pritje e përcjellje e forcave partizane, që vinin nga pjesa tjetër e Mokrës dhe drejtoheshin për të bërë prita forcave fashiste e naziste gjatë Luftës së II-të Botërore në Qafë-Thane, në Pojskë, Guri Urakës të cilat bllokuan rrugën Prenjas-Pogradec, Qafë-Thane-Pogradec dhe anasjelltas ka shërbyer si vend strehimi e ushqimi e forcave partizane. Për historinë e këtij fshati jam munduar të shkruaj në gazetën "Mokra" Nr.6,7,8 - 2001 "Pak histori për Homeshin". Qëllimi i këtij shkrimi është për të pasuruar sadopak historinë dhe për të parë përbërjen e shtimin e popullsisë, shpërndarjen gjeografike si dhe studimin statistikor të popullsisë së fshatit duke parë disa periudha sidomos pas mbarimit të Luftës së Parë

ZHVILLIMI DEMOGRAFIK I FSHATIT HOMESH



Homeshi ne 1961

Botërore në fillimet e Luftës së Dytë Botërore si dhe zhvillimet pas viteve 1940 deri në vitin 1990 si dhe lëvizjen e popullsisë pas viteve 1990 (në periudhën e tranzicionit) deri në fund të 2008-tës, me qëllim, që sadopak do të shërbejë për moshumbjen e origjinës dhe të identitetit të secilit fis e person, që ka lëvizur.

Lufta e Parë Botërore e ka shkatërruar plotësisht fshatin Homesh. Të parët që kanë shkelur fshatin rreth vitit 1916 qenë ushtritë austro-hungareze e bullgare. Ato duke ditur se do të përplaseshin me ushtritë e Antantës franceze, greke etj. e shpërngulën fshatin me gjithë ç'kishin, gjënë e gjallë, bereqet, fëmijët dhe gratë e i vendosën në fshatrat Katjel, Kododesh, Rajcë si dhe në disa fshatra të Maqedonisë si Radolisht, Ferngore etj., nëpër miqtë (muhaxhirë). Ndërsa një pjesë të burrave i dërguan në kampet e përqendrimit në Bullgari. Ndërsa një ditë më vonë fshatin e shkelën ushtritë franceze. Ato gjetën pleqtë e plaka, që kishin qëndruar për të ruajtur shtëpitë që të mos grabiteshin nga njerëz të pa ndërgjegjshëm. Ata (francezët) i morën e i strehuan (muhaxhirë) në fshatrat e zonës së Pogradecit e Vërdovës e Zagorcanit (gratë) ndërsa burrat i dërguan në kampet e Follorinës. Pas 1-2 vjetësh (1916-1917-1918) kur filluan të largohen ushtritë e huaja, kur po i vinte fundi Luftës së Parë Botërore (1918) banorët e mbetur gjallë filluan të rikthehen në shtëpitë e tyre, por ata qenë shumë pak sepse një pjesë e burrave në kampet nuk u kthyen më dhe së dyti epidemia e tifos që kishte rënë në atë zonë e çfarosi popullsinë. Ata pak banorë të fiseve, që përmendëm më lart u rikthyen në banesat e tyre të vjetra e të shkatërruara plotësisht, pa dyer e dritare, i kishin mbuluar hithrat e ferrat (nga tregimet e të parëve).

Sipas një studimi real e faktik, duke biseduar edhe banorë

të moshuar të fiseve të mësipërme si me Halil Menkshin, Maliq Menkshin, Mehmet Gjatën, Adem Pengun, Sadush Bizgjani si dhe nga kujtimet e mija të fiksuara nga prindërit e mi, që e kishin jetuar atë periudhë arrita në disa konkluzione realiste:

Së pari banorët e rikthyer sipas fiseve pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore e ringjallën fshatin përsëri duke meremetuar shtëpitë sipas mundësisë për të futur kokën, duke hyrë në marrëdhënie me miqtë e fshatrave të tjera që ishin dëmtuar më pak, bashkonin ndonjë ka apo lopë për të punuar tokën, që të siguronin pak bukë. Filluan të shtonin blegtorinë, mbasi vendi kishte kushte të mira kullote. U bënë lidhje martesore të reja dhe kështu banorët filluan të ripërtërihen, numri i tyre filloj të shtohet. Gjatë periudhës prej viteve 1918-1920 deri në vitin 1940 banorët e këtij fshati secili sipas fisit e marrëdhëniet me fiset e tjera brenda fshatit u mbështet e jetoj me mundësitë e djersën e tij, duke punuar tokën, duke shtuar blegtorinë, me të cilët siguronin edhe nënproduktet si qumështin, gjalpin, djathin, mishin etj. dhe i tregonin në tregjet e kohës si në Pogradec, Strugë, Korçë etj. dhe blinin drithëra buke. Veshmbathjen banorët duke shfrytëzuar traditën, më të shumtën e siguronin vetë. Gratë mbillnin, shumica e fshatit kërpin (200-500 m²) (bimën që sot të fut në burg). Ato e përpunonin dhe merrnin fjetet dhe punonin pëlhurat e bardha me anë të tezgjahut (vegël pune) të cilat përdorshin për këmishët e veshjet e tjera të grave si dhe këmisha për burrat. Këto pëlhura për nga fortësia ja kalonin bluxhinsit të sotëm. Po kështu përdornin leshin, e krihnin e dridhnin në boshte e kalonin në tezgjah, pastaj e dërstin dhe bënin veshje për burrat ose xhoke për gratë e xhamadanë për burrat. "Kapucët" i siguronin prej lëkurëve të lopëve që i thernin nga skartimi dhe e bënin pastërma ose conserva

(kaurma) i siguronin edhe opinga prej gome, që e sillte ndonjë hallexhi nga qyteti, të qepura me spango ose riparoheshin me fije të li nga vetë banorët.

Për sa i përket sheqerit ata e siguronin nga prodhimet e hardhisë, (rrushit) duke përpunuar me teknologjinë e kohës dhe prodhonin me shumicë pekmez-in, nardenin si piqe freskuese. Drithin që siguronin e bluanin në mullinj të fisit dhe një mullin e fshatit mbasi fshati duke shfrytëzuar burimet e ujit kishte ndërtuar tre mullinj që vinin e bluanin edhe fshatrat përreth si Seleqposet, Hamçani, Radoldet etj. Ndërsa në tregjet e kohës burrat blinin shumë pak sende si ndonjë kg. sheqer për kafe, ndonjë litër vajguri për kandilin ose ndonjë llambë që kishin sjellë kurbetlinjtë që kishte mjaft prej tyre që patën shkuar për të siguruar ndonjë pare si në Rumani, Turqi, Argentinë etj. të cilët sillnin ndonjë jorgan për të fjetur ndërsa pjesa më e madhe e familjeve e siguronin nga punimi i velenxave të leshit të deleve e përzier me lesh dhie si dhe gunave e lëkurëve të deleve.

Në tregje blinin edhe ndonjë basme e shami të kuqe ose për dumanet e disa grave.

Shteti që funksionoj pas viteve 1924 deri në 1939 nuk jepte asnjë ndihmë për fshatin, vetëm merrte një taksë (të dhjetën) si për blegtorinë ashtu dhe për prodhimin bujqësor. Vetë fshati ruante pyjet, kullotat për të mos i dëmtuar banorët kufitarë si Rodokoli sipër, Hualënisht, Çervenaka, Oshtëca, Homçoni, Selca poshtë e Kriçkova. Vetëm me anë një roje (pojaku).

Në vitet 1939-1940 kur popullsia e fshatit kishte filluar të shtohet e të ripërtërihej nëpërmjet martesave e shtesave natyrore, kur kishte filluar të ripërtërihej ekonomia, të shtoheshin blegtoria, të krijoheshin tufa të mëdha e të bashkoheshin në stane me nga 200 e 300 kokë bagëti dele e dhi qumështi të punohej me një teknologji më të mirë dhe secili

nga fshatarët merrte sasinë e bulmetit sipas sasisë së qumështit, të matur ditën e bashkimit të tufave nga fillimi i majit, kur kishin filluar të përmirësoheshin mjetet e punës, si parmenda e drurit, plugjet e hekurit, shata, lopata, sëpata, sqepari, çekiçi e mjeshtërvë të kohës (kovaçët), kur ishin krijuar mënyrat e reja për të shpëtuar nga varfëria e krijuar nga ushtritë e Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore. Rifilloj përsëri Lufta e Dytë Botërore, ku ushtritë e Benito Musolinit pushtuan Shqipërinë dhe bënin propagandë nëpërmjet fletushkave, që hidhnin me anë të avionëve.

Populli të mos frikësohej se Duçja do të sillte "mirësinë". Por populli e sidomos të moshuarit, që akoma s'kishin riparuar të këqijat që u solli Lufta e Parë Botërore, prej Fuqive të Mëdha të cilat me lakmitë e tyre për pushtimin e botës dhe për të vjelë pasuritë e popujve të vegjël e sollën jo "mirësinë" por dëme shkatërrimtare ashtu si gjithë vendit edhe fshatit tonë.

Këta perandorë lakmitarë, me shumë pasuri në pragun e vdekjes gjithçka e bënin për emër e lavdinë e tyre.

Në vitin 1939-1940 kur Ushtritë e Musolinit pasi kishin pushtuar Shqipërinë, kur kolonat ushtarake të shoqëruara nga bersalierët me motoçikleta e me pendët mbi helmata kishin marrë rrugën drejt jug-lindjes (Korçës) për të pushtuar edhe vendin fqinjë (Greqinë), të gjithë në të vegjël e të mëdhenj, që i shikonin na hyri frika e tmerrit që nuk harrohen edhe sot, për ata që e kanë parë. Në këtë kohë fshati përbëhej prej 31 familje me 338 banorë të ndarë sipas fiseve të mëposhtme:

Gjatat 8 familje, 90 banorë, Bezzjonët 7 familje me 63 banorë, Pengajt me 6 familje me 70 banorë, Menkshajt 4 familje me 53 banorë, Çollarët 4 familje me 49 banorë si dhe fisi Damore, që para fillimit të Luftës së Parë Botërore kishin qenë familje e madhe por e shoi dhe nga fisi tyre mbeti gjallë vetëm një djalë rreth të 16 vjetët, Sali Damo, dhe një gjyshe e cila e martoj nipin dhe më 1940 familja e ripërtërirë me 2 familje me 13 banorë.

Për sa u përket numrit të frymëve në raport me familjet në këtë periudhë mund t'i quajmë si familje të mëdha të cilat punonin e jetonin bashkë, me vëllezër e motra, e kunata me detyra të ndara nga kryetari i familjes. Por qetësia u prish përsëri nga të "mëdhenjtë" nuk e lanë rehat popullin e vogël. Burrat e vjetër (kryefamiljarë) nën drejtimin e kryepleqësisë mbledheshin çdo ditë të xhamia të shqetësuar se ç'mund të bënin, mbasi në atë kohë nga shteti nuk kishte asnjë informacion, asnjë këshillë. Pra populli kishte mbetur si tufa pa bari. Shumë të çorientuar dhe prisnin me ankth se të huajt nuk e deshën, që të shkelin Shqipërinë, Mokrën e fshatin e tyre dhe bisedonin çdo ditë se ç'mund të bënin si: Haxhi Menkshi, Demish Gjata, Istref Pengu, Rexhep Pengu, Saip Bizgjoni, Sali Damo, Bezat Çollari e tjerë. (vijon)



NË LABIRINTHET E MONUMENTEVE KULTURORE, HISTORIKE TË PËRLOTSHME



si Kutuzov dhe Bagratov i kishin ndihmuar të shpërngulurit shqiptarë që u vendosën në Stepan e Buxhakut. Gjatë viteve 1809-1813 prapa Danubit ishin ngritur fshatra me shqiptarë si Kubej, Tashburnar, Çijleja, Çeçnija, Varania etj. Urdhri i Aleksandrit të parë

Nga Llazi TONA

-NJË NGA UDHËTIMET MË TË BUKURA

Në vitin 1958 një delegacion klerikal krishtero-ortodoks i kryesuar nga mitropoliti Dhimitër Kokoneshi (Damjani) ndërerr një vizitë të dytë për në BRSS. Udhëtimi kryhej me një mjet detar i destinuar për transport njerëzish. Pra një vapor modern që plotësonte kushtet më të mira optimale për njeriun. Një udhëtim nga më të mrekullueshmet përmes Adriatikut e Jonit, e kalon Korfuzin, Ishujt e Qefalisë, Brigjet e Peleponezit, Ngushticat e Lakonisë duke lënë kështu Detin e Mesdheut dhe futen në Detin Egje (Foto nr.1)

Udhëtohej në një kohë mjaft e mirë, pra një lundrim i qetë, pa dallgë në det dhe qiell të kaltër. Udhëve këmbëhej me anije të tjera detare dhe varka peshkatarësh. Një shumëllojshmëri shpendësh herë-herë shoqëronin vaporin me fluturimin e tyre.

Hynë në Ngushticën e Dardaneleve (term ky që vjen nga shqipja Dardan) ku brigjet e tyre ishin mbushur me një gjelbërim të mahnitshëm e të këndshëm. Në një mëngjes ku nuk kish dalë akoma dielli kalojnë Çankalanë. Përpara ata kishin Stambollin pra Konstandinopojën, emërtim ky i vendosur që kur ishte gjallë perandori i madh dhe gjenerali me famë botërore Konstandini i Madh me origjinë ilire.

KISHA E MADHE E SHËN SOFISË

Kaluan përbri asaj pjesë të Stambollit ku ngrihen mbi godinat Kisha e Madhe e Shën Sofisë. Mitropoliti Damian që njihje mirë historinë e krishterimit ortodoks nga që kish përvetësuar më së miri doktrinën e ortodoksizmit jo vetëm në shkollën normale të Manastirit më 1896 por edhe Akademienë e Teologjisë në Janinë më 1925, nuk mund të rrinte pa folur kolegëve për këtë kishë të madhe të Shën Sofisë. (Foto 2)



Kisha e Madhe e Shën Sofisë - tha ai - filloi të ngrihej nga Konstandini i Madh dhe e përfunduar nga i biri Konstanc që dhe ai ish perandor i Romës dhe Bizantit në vitin 336.

Pas shpërthimit të Kryengritjes së Nikës (3 Janar 532) me këtë rast digjet dhe pallati perandor dhe një numër të madh kisha të Konstandinopojës.

Pesë javësh pas shpërthimit të Kryengritjes së Nikës (15 janar 532), më 23 shkurt Justiniani (Foto 3) e rindërtoi nga e para Kishën e Shën Sofisë. Edhe Justiniani i parë perandorë ilirë. Për 38 vjet me radhë që nga Ungji e deri tek nipi Justinianë drejtuan perandorinë bizantine e asaj kohe e shtrirë në tre kontinente. Asnjë perandor para dhe pas tij nuk ngriti më shumë se sa perandorët Justinian.

Justiniani I-rë iu dha mundësia që ta zbuluronte kryeqytetin. Sipas shijes së vet Perandori Justinian I-rë siguroi mjetet që nevojiteshin sipas shijes së vet.

Midis ndërtimeve të shkëlqyera si Patheoni, Anthines dhe Kisha e Shën Pjetrit ndërtuar nga Perandori Konstandini i Madh edhe Kisha e Shën Sofisë ngritur mbi gërmadhat e mëparshme ishte pa dyshim monumenti më i famshëm i botës dhe kjo ishte Kisha e Re e "Urtësisë Virgjërore". Katedralja e Konstandinopojës, "Kisha e Madhe" e Shën Sofisë radhitet në një nga mrekullitë e mëdha botërore. Perandori Justinian i pat thënë arkitektit të kësaj Kishë-Antkemissit të Trallesë: "Mos kurse asgjë, që ajo të jetë më e bukura në botë, që emri i zotit dhe imi të amshohen".

Antkemissi ishte një ekspert në zbatimin e arkitekturës së gjeometrisë; i cili zinte një vend mbizotërues në studimet e epokës. Kisha e Shën Sofisë ka në bazë një katërkëndësh, përmasat e sëcilës janë 77X71.70 metro, në një lartësi prej 55 metrash, kurorëzohet me një kube gjigande e cila ka një diametër prej 31 metro e mbështetur në katër harqe të mbështetur dhe ato në gurë masivë. Punimet për ndërtimin e Kishës së Shën Sofisë zgjaten e rrumbullakoset 5 vjet e 10 muaj dhe inaugurimi i saj u bë me 26 Dhjetor 537 Shën Sofia u quajt shpesh një krijesë arkitektonike mbinatyre një mrekulli e hapësirës.

Në pikëpamje arkitektonike mrekullia e madhe e Kishës është kubeja e befasueshme. Zbulimi i brendshëm ishte një luks edhe më shumë mahnitës, çdo gjë ishte e punuar me ar dhe argjend. Fjala vjen, llambat dhe qirimbajtësit e tërë hapësira që gjatë natës i jepnin një ndriçim



të shkëlqyeshëm. Muret, shtyllat dhe harqet qenë veshur me gur të çmueshëm dhe fildish çdo gjë ishte e përlogaritur shkencërisht të dritës natyrore. Kishte edhe mbulesë të stërholluar skulpturore e mozaik nga më të ndryshme, që fatkeqësisht turqit i patën hequr ose mbuluar me ndonjë shtresë të re, me që sipas parimit të besimit mysliman është mëkat paraqitja e përfytyrimit njerëzor në mure ose gjete në tempuj fetare.

Ceremonia e inaugurimit të Kishës së Madhe të Shën Sofisë, Justiniani e shndërroi në festë të madhe dhe gjithëpopullore të shoqërisë dhe me falje të shumta. Justiniani nuk u vinte veshin shpenzimeve kur ishte fjala për zbulimin sa më të suksesshëm të Shën Sofisë me ar, argjend dhe gurë të çmuar. Zbulime ju bënë shenjtorëve të krishterimit Ikonastazit dhe Altarit të cilat ishin veshur nga ari i pastër. Froni i Patriakut ishte nga argjendi dhe peshonte 40.000 hb, që do të thotë kushtonte kundër vlerës së 145.052 kg. të arit, shumë kjo e papërfytyrueshme.

-NJË VEND ME RËNDËSI TË MADHE HISTORIKE

Vapori transportopasagjerësh kalon përballë e përbri të Azisë së Vogël. Kushdo që kalon nëpër këtë vend me rëndësi historike nuk mund të mos vështrijë Ujdhesën Tenede ku ishte fshehur Ushtria greke, duke lënë atje kalin e drunjtë në fushën e betejës pranë Trojës. Klerikët shqiptarë përqendruan shikimin e thellë mbi Trojën, një vend i rënuar nga shekujt por kthyer në legjendë nga Homeri i Madh.

-NGA VARNA NË ODESË

Mbërrinjë në Varna të Bullgarisë një qendër mjaft e rëndësishme ballkanase, tranzite për emigrantë shqiptarë, bullgarë, maqedonas, vllahë e grekë, që para se të shpërndaheshin nëpër vendet e tjera botërore. Ata qëndruan në fillim në Varna dhe fshatrat për rreth saj.

Njohës i mirë i traditave të



Delegacioni gjatë udhëtimit

zakoneve shqiptare në Varna K. Kricik ve në dukje se shqiptarët krishterë-ortodoks në këtë vend flasin shqip por nuk e shkruajnë në gjuhën shqip, nga që nuk ka shkollë për të mësuar shqip.

Nga Varna udhëtojnë drejt Dobruzhës-Balkanik-Konstancë të Rumanisë pastaj në Odesë të Ukrainës. Legjendat, gojëdhënat, shkrime të shumta të botuara nëpër libra dhe revista ukrainase tregojnë se në Ukrainë kanë emigruar një numër të konsiderueshëm shqiptarë nga Mokra, Shpata, Korça, Erseka e Devolli.

-NË ODESË

Nuk mund të mos ndalemi edhe në disa fakte historike që tregojnë se shqiptarët morën pjesë në themelimin e qytetit të Odesës, ku nga vitet 1794-1795 ekzistojnë dhe rrugët "Belshajt Arnautskaja" edhe "Mallaju Arnautskaj". Kisha si ajo e Shën Marisë ndërtuar me shpenzimet e shqiptarëve në fshatin Karakurt në të cilën janë vendosur dhe fshatarët e Çorodolit dhe Vemiranit të Mokrës së sipërme.

Klerikët shqiptarë bënë një vizitë në muzeun historiko-etnografik të qytetit Bollgud të Qarkut të Odesës, muzeun historik etnografik dhe arkeologjik të qytetit Odesë dhe Izmail.

Ata mësuan atje se udhëheqë-



nga 29 dhjetor 1819 përmbante privilegje për të shpërngulur nga viset e Ballkanit ku në të përfshiheshin dhe shqiptarë (Foto 5). Ata morën nga 60 desjatura (një desjatim = 1.092 ha) për çdo shtëpi, hua të madhe dhe favore të ndryshme. Kështu dhe favore të tjera nuk paguanin taksa dhe tagra për 10 vjet nuk merreshin ushtarë e tjerë.

-Del pyetja pse këta shqiptarët shkonin deri në Ukrainë. Duke u mbështetur në burimet arkivale të shpjegojmë disa fakte.

Në kohën e sundimit turk fshatrat malore shqiptare si Mokra, Shpati, Gora, Opar Grunesh e tjera bënin furnizimet me bagëti dhe me prodhimet blegtorale. Që në fillim të sundimit turk ata paguanin taksa shumë të rënda arkës së sulltanit (xhizja apo haraçi) për çdo kokë bagëtie që shlyheshin me para nga burrat krishterë. Taksa shumë të rënda ishin vënë dhe për çdo shtëpi apo kasolle që kish çdo fshatar. Më vonë ata u ngritën kundër kësaj gjëje. Ata shpesh nuk u lejonin taksambledhësve të hynin në tokat e tyre dhe prapsnin ekspeditat ndëshkimore të trupave turke.

Në epokën e sundimit turk shumë shqiptarë kërkonin strehim në vende të thella malore ku mund të fshiheshin kollaj për t'u mbrojtur nga agresioni. Natyra u ndihmonte dhe i përkrahte, veçanërisht në dimër, kur nga ortekët ngandonjëherë në katundet tepër malore mund të izoloheshin.

(vijon)

Disa ditë më përpara shkova në arkivin e rrethit, isha i interesuar për një dokument pronësie dhe mësova se përgjegjësjë kish qënë e bija e një profesorit tim të dikurshëm GJ. Gusho. I them asaj se nëse i ke ngjarë babajit, ti je njeriu i përkryer për këtë detyrë. Duke parë kureshtjen e saj, që desh të dinte se çfarë vlerësimi ruaja unë për Profesorin e viteve 1963 -65, i them të lexonte Nonda Bulkën (Chri - Chri) "Kur qante e qeshte Bilbili", tregimin që titullohet "Topazoja" dhe besoj se ai ka qënë fotokopija e tij, e babait tënd, për aq kohë sa Topazoja punoi Mësonjës. Pak ditë më përpara e pashë Profesorin tim të dikurshëm, tashmë në pension, dhe e ftova për të pirë qoftë dhe një kafe e për t'i thënë diçka. E më pas e pyes në se ishte po ai njeri, profesori i patolerueshëm i gjuhës ruse apo ish-tjetërsuar në vite.

Dhe profesorin e bëra të vihej në mendime e më pas ai më tha: "Dëgjo, Koço, më ke bërë një pyetje interesante. Më dëgjo, do t'ju rrëfehem, pastaj do më thuash ti nëse jam ai profesori tënd i dikurshëm apo kam ndryshuar". Dhe filloi të tregojë një histori që e kish zanafillën fill pas atyre viteve 1966-1967. "Unë kisha ngelur në rusisht një nxënëse me riprovim në vjeshtë, për të cilën ishte i interesuar Sekretari i Dytë i Komitetit të Prtisë në Rreth, nis rrëfimin e tij profesori. Më vjen dikush e më thotë ta kisha kujdes atë vajzë, ta kaloja, se kishin porosi nga shoku T.K. Unë i them atij personit, se ajo duhet të përpiqet se ndryshe unë nuk kam si e kaloj po nuk m'u përgjegj. Personi ia çon përgjigjen e fjalës që unë i thashë, por duket që ai nuk e priti mirë e nuk vonoi as dy ditë nga kjo bisedë dhe mua më thëret shoku Sekretar në zyrë dhe pasi më përgëzoi për punë të mirë më tha: "Partia ka nevojë për punën tënde në një sektor shumë të rëndësishëm, ti duhet të kalosh pranë Muzeumit të Rrethit e të punoni me ndershmërinë që ju karakterizon në ngritjen e muzeumeve se të gjitha fshatrat e rrethit!" Ashtu u bë. Në vënd tim u emërua mësues dikush që bëhej fjalë për ta diskutuar fjalën e shokut T, po ja nxori notën 10 dhjetë edhe në dëftesën e pjekurisë. Dhe unë me të ndjerin Vang-

jush Manastirliun e Dhimitër Ristanë, nuk lashë fshat pa shkelur për 3-4 vjet resht për ngritjen e muzeve. Një herë, diku në një fshat të Mokrës po bisedoja me një plak të vjetër, plak të zgjuar dhe i rrahur nga jeta. Ai jo paqëllim më rrëfeu historinë që do tu tregoj unë "Njime" ty. Dikur ish një person i mirë i drejtë po që e kish zënë një hall, se i kish dalë një xhungë (tumor) në shpatullën e djathtë dhe ia kish vështirësuar përdorimim e krahut e ia kish humbur qetësinë e gjumin. Nuk kish lënë vend e doktor pa shkuar, po nuk gjeti shërim e medet gjekundi. Dikush që ia dinte hallë, i thotë se dinte ai një vënd ku me patjatër gjen dermam e shefajet (shërim)! Po ku more, aman, më thuaj! Dhe ky miku i thotë të shkante të lutej në një vënd të Shenjtë. Ky miku jonë ashtu bëri, shko i atje dhe i thonë se kjo punë është e mbaruar por se ai duhet të vinte ditën tjetër se atë ditë e kish zënë dikush dhe se dy persona me të njëjtin hall nuk pranoheshin. Ditën tjetër vjen përsëri ky miku ynë me një dash lidhur me një porozhe e marrë për dore për ta bërë kurban në vakëf. Sapo arriti në vakëf, shikon atë personin që kish zënë rradhë një ditë më parë dhe që kish pasur një hall me të. Si e përhëndeti e pyet, si i kish shkuar puna me hallin që kish e ai shumë i kënaqur lavdëronte Zotin e thoshte që ishte i shëruar plotësisht e siguron se tamam të njëjtën gjë kish pasur dhe ai, por vetëm se e kish në krahun e majtë. E ky miku që kish hall e pyet se si kish ndodhur mrekullia? E personi në fjalë i thotë se kur atë e kish zënë gjumi në vakëf i vinë disa vajza a zana e i thonë që të ngrihej e të merrte një valle me to, më pas më thanë që të thosha unë, ato fjalë që thoshin ato. E fjalët që thoshin ato ishin: e premtë, e shtunë e hënë! dhe si u përhëndoshën ai, ish-pacienti që gjeti

shefajet në vakëf u largua tërë qef.

Po kështu i ndodhi e këti mikut tonë gjatë natës që fjeti atje, po me një ndryshim, se kur ato i thoshin të përsërisre fjalët sipas tyre d. m. th. e premtë, e shtunë e hënë. Unë thosha e premtë, e shtunë, e dielë, se e diela vjen pas të shtunës. Për çudi në mëngjes kur u zgjua shikon që i kish dalë dhe një tjetër Xhungë po kjo në shpatullën e majtë! Dhe kuptova që dhe mua gati kështu më ndodhi, valla për punë të bërë mirë ma shpërblyen duke më degdisur disa vjet në fshat. Kuptova se i drejti vuan, fitojnë pelivanët, servilët së paku këtu ndodh tek ne, ku nuk dëgjohet e zbatohet ligji, po ligjin vazhdon ta bëjë Partia. Paritë me kryetarët e tyre, që kërkohet shpesh të hidhen këmbët në valle, ashtu si bie daullxhiu daulles, është fatkeqësi, po kështu po ndodh e sot e kësaj dite tek ne. Duket se në fuqi nuk është e "drejta", duket se të drejtën e ka mbajtur gjallë gjenjshtrë! Duket që hajduti ka ndihmuar të drejtin qoftë dhe një herë, prandaj, maskarenjtë duhet t'i nënshtrohet i afti, i drejti, i nderëshmi të djallëzuarit e djallit vetë që në të shumtit e rasteve e ka pasur dhe e ka emërin parti. Ky rrëfim mbase mua më bëri të mendohem dhe besoj se më vlejti, prandaj këtij rrëfimi mund t'i shtohet e dilema shekspiriane. O botë e poshtër, o drejt, unë nuk kam forcë e mundësi të të ndreq. Apo thënja e popullit "kot na gënjën mëndja, në këtë botë nuk e gjen të drejtën" dhe mbase kjo më bëri që dhe unë më pas e kam hequr vallen, sipas daulleve që kanë rënë më pas. Po kjo nuk do të thotë se unë kam luajtur në aktin e dytë si ai personazhi i N.Bulkës ai ish mësonjësi "Topazoja" mbasi nuk është në natyrën time, se jo gjithkush i bën të gjitha të zezat si mashtrimin, vjedhjen, pabesinë, hipokrizinë, krimin, që në saj të tyre shumë u

pasuruan e u bënë të nderuar, me emër e me famë, prandaj mbase thuhet paç fatin e të ligut, A paç fatin e K....s. Gjë që është e vërtetë absolute sot, Kur shikon dikë sot ish-mësonjësi i dobët gjuhësh të huaj, pa asnjë vlerë, pa kontribute që s'kanë lënë asnjë gjurmë në profesion e braktisën profesionin dhe u veshën në polici me grada u pozicionuan nëpër trarët e Doganave, Tamam kjo më ngjan me një roman të titulluar "Pirati bëhej Papë" ku njerëz të lidhur me kondrabandën e krimin ekonomik, si dhanë prova se ishin të zot për punë të pista u katapultuan në krye të Partisë e të Qeverisjes vendore, ku këta sot janë bërë monsrëra të afërave e mitmarjeve, që firmojnë në 7-8 bordero e përfaqësojnë një "takëm" që e duan më shumë Shqipërinë se ne qytetarët e drejtë të këtij vëndi, aq e vërtetë është kjo sa kanë lënë në Sh.B. A. Vetëm numurat e llogarive bankare dhe me vrap kanë ardhur këtu e punojnë për "bukën e gojës" këta qafirë dhe posedojnë vetëm nga një Grim Kart të gjorët që e shkelin 1-2 herë në vit e me vrap vinë e punojnë këtu në viset tona si ndozot në Pogradec, në qytetin tonë të dashur, sic thashë për bukën e gojës! Dikur tregoj për disa kurbetlim fatkeq që su ecte kurbeti e këtheheshin si Gollanë Rumanie ju thoshin pa lek, ndryshe ndodh me këta të qojtur Gollanë politikë që kur ndodhin rrotacione pushtetesh shkojnë me vrap në ShBA a Kanada a gjetiu si azilantë politikë, jo për të punuar të kuptohemi, por se këtu kanë hesape për të larë, dosje të mbullura të vjetra e të reja që ka mundësi, do vijë dita tu rihapen nga shteti i të drejtës, nga shteti ligjor një ditë.

Në ka Perëndi, unë besoj se ka, deri kur u dashkan të qeverisemi nga ca mafjoza që kanë rëmbyer ka flamuj blu, ca të kuq nga jashtë, por që janë katran të zinjë sterë në ndërgjegje e në shpirt. Të mendosh idealet e Dhjetorit të vitit 91 e ti krahasosh me disa horra të emëruar në sot në pushtet, ky është fatalitet. Ky mesazh duhet të kihet në parasysh mirë e në këto zgjedhje, të mos ndodhë që në vënd që ti, o popull zot në këtë vënd, në vënd që ti shërbehet, ndodh që duhet ta mbajë në kuriz lloj lloj fundërina.

Pogradec më 29 -11- 2008

MOKRA PËRBËN NJË PELLG TË KUFIZUAR QARTË

(vijon nga faqja 3)

Në ushrinë e Skënderbeut bënë pjesë edhe reparte të përbëra nga bij të Mokrës, të drejtuar nga komandantë popullorë, këta jo vetëm u bënë ballë, por thyen me trimëri hordhitë osmane përpara të cilaëve dridhej Evropa.

Për qëndrimin e Skënderbeut në këto anë flasin një numur toponimesh si Qukës Skënderbe, Rrajcë Skënderbej, Shkalla e Skënderbeut, Sofra e Skënderbeut, (Guri i Pishkashit) e tjera. (Servet Lamçe "Kronikë shekullore në brigjet e Liqenit,, Tiranë, 2004, faqe 31).

Përballë tribalëve ishte një vend fort i bukur i asaj krahine, shumë i populluar dhe plot me katunde të dendura, banorët fqinjë e quajnë Mokër. Skënderbeu e zuri menjëherë i pari dhe u mbush me ushtarë të armatosur në një luginë të ngushtë që e quajti Lugina e Mokrës dhe që ishte e vetmja rrugë kalimi për barbarin. (Marin Barleti, "Historia e Skënderbeut,, Tiranë 1983, faqe 175). Një fitore tjetër u shënua gjithashtu në grykat e malsisë Mokrës më 27 gusht 1462, ku shqiptarët shkatërruan një ushtri prej 25000 vetë dhe zunë të gjallë edhe komandantin e saj.

Sipas regjistrimeve turq të vitit 1467, Sopot i figuron midis 34 fshatave, ku për atë kohë sipas kujtesës së Gjon Muzakës ndahet në; Sopot, Polis dhe Bërzeshitë, Çermenikë e Poshtme, Çermenika komplet, Dibra dhe Dibra e Poshtme. Këto treva ndodheshin nën zotërimet e familjes së madhe të

Aranitëve (Gjergj Golemi). Fillimet e tij Sopotit i ka rreth viteve 1001 me David Aranitin, i cili ishte ushtaraku më i lartë në Shkup. Kalaja e Sopotit ra në vitin 1470, vit kur mori fund qëndresa e shqiptarëve ndaj turqëve e aranitët të trashëtuat nga rojet besnike të tij.

Blektorët e Llëngës në Kazanë e Starvës nuk paguan taksat e tepërta të kërkua nga mytesarifit për bagëtinë e tyre, për të cilën ata ngritën zërin deri tek Sulltani. (AQSH, Regjistrimet e zyrës së Sheries faqe 128, dosje,21). Për të siguruar zotërimin e pjesës më të madhe të të ardhurave të pronave të tyre, i kthyen të gjitha pronat në mylk në vakëfe. Gjatë shekullit të 16-të ishin kthyer në vakëfe mylket toksore të shumë fshatarëve, midis tyre edhe fshati Rrajcë, i nahijes së Mokrës. (Pronësia feudale në tokat shqiptare shekulli 15-16-të).

Në regjistrimet turke të vitit 1519 në krahinën e Mokrës janë 38 fshatra, me 1503 familje, ndërsa në regjistrimet e vitit 1583 janë 1772 familje .

Nga gjysma e shekullit 18-të Sul Starova prej kazasë Mokrës dhe Gorës, që ishte i pari i vëndit të vet dhe kishte si kapedan mikun e tij më të dashur Bendon (Bendo Shapërdanin) një krishter prej Alarupi. (Bleta, nga Thimi Mitko).

Mokra mbesheteti lidhjen e Prizrenit më 10 qershor 1878, dhe delegatet arritën atje një ditë më parë. Vendimet e Lidhjes së Prizrenit i bëri të njohura vetë udhëheqësi i Lidhjes, Avdyli Frashri ku në gusht të vitit 1878, qëndroi per disa ditë në Pogradec.



Vendimet e Lidhjes së Pejës në shkurt të vitit 1899 i u njoftuan në mënyrë të fshehtë shumë krahinave, midis tyre edhe Starovës. Popullësia e kazasë së Starovës me atë të Pogradecit e fshatrave përreth u bashkua me Lidhjen e Pejës në mars 1899. Bashkimi i saj me lidhjen u arrit tërsisht me nismën e popullit, dhe me përpjekjet këmbëngulse të atdhetarëve, midis të cilëve u shquan Hasan Blloshmi nga Brzeshta, Iljaz Kotodeshi, e Hajdar Kotodeshi. U zgjodh komiteti i Lidhjes prej 20 antarësh. Duke u bashkuar me Lidhjen e Pejës popullsia e kësaj krahine kërkoi edhe çeljen e Shkollave Shqipe dhe levrimin e gjuhës amtare.

Istref Beu, stërnipi i Sul Starovës, që luftoi deri në fund të jetës së tij kundër osmanëve, e renditi veten në anën e pushuesve osmanë gjatë zhvillimit të ngjarjeve të Lidhjes së Pejës.

Për forcimin e unitetit dhe ndërgjegjes kombëtare u formua në nëntor 1905 "Komiteti për lirinë e Shqipërisë,, që u ngrit në shumë krahina. Një nga drejt-

tuesit kryesore, ishte Halit Bërzeshita, nga Bërzeshita, Kryefarmacisti i armatës turke me qendër në Manastir.

Në krahinën e Pogradecit, Mokrës vepronin çetat e komanduara nga Kajo Babjeni, Shaban Matraku, Ismail Derdusha e tjere, duke u ndeshur me koshardhet turke, u shkaktuan atyre shumë humbje.

Mokra përkrahu levizjen xhon-turke, që synonte në përmbyshjen e regjimit absolutist të Sulltan Hamitit dhe për vendosjen e rendit kushtetues. Shumë mokrarë morën pjesë në mitingun e zhvilluar në Shën Naun, bashkë me burra nga Pogradeci, Starova, Gora, Çërrava e fshatrat e Rrëzës.

Më 19 shtator 1908, u ngrit 'Klubi i Pogradecit me kryetar Ahmet Starovën, nënkryetar Hajdar Starovën, arkëtar Jashar Starovën, kontrollor Asllamn Minarolli, sekretar Hysni Starova, pleqësia Gjokë Ndika, shkronjësa Sandri Nauni dhe LLazar Kozmai. (AQSH, Fondi 102, dosja 141 faqe 1).

Populli i nënprefekturës së Starovës, autorizoi si delegatë në Kuvendine Vlorës, më 28 nëntor 1912 Hajdar Blloshmin dhe Mustafa Baruti delegatë i Strugës dhe i Ohrit arritën atje në mbledhjen e shtatë, më 7 dhjetor 1912. Telegrami si përfaqësues të popullit e nënshkruajnë 15 vetë, nga Starova, Bërzeshita, Velçani, Quksi, Debroya, Straniku, Kotodeshi, Dardha, Homçani e tjerë.



Nga Istref HAXHILLARI

Vdekja e Vasos që e dhimbshme. Përtej vdekjes ishte zhbërje e lemerishme pa varr, pa nam e nishan. Në buzë të natës, shpuar nga thikat e mënyrëshme të shokëve të udhëtimit, u zhyt në thellësitat e rrëmbyera të Vardarit. Lumi i egërsuar, mbuluar me shkumën e verdhë prej dheut të huaj e mbështolli në gjirin e errët trupin ende të ngrohtë. Vrasësit qenë dy. Nuk i shkonte kurrë në mendje se do të vdiste aq shpejt, sidomos në atë mënyrë të llahtarshme. Tashmë që shndërruar në fantazmë, hije, erë që rrihte shkëmbinjtë apo zëri i lumit, dëgjuar vetëm prej zemrës së atyre që e prisnin prej kohësh. I vdekuri është i përkorë, zemërmadh, nuk kërkon asgjë. Të gjallët janë grykës të pangopur, makutë të mëdhenj, nuk u mjafton bota e tërë.

Punonin në të zezë. Vasos i eci dhe për afro dy vjet vuri goxha para. Të hollat i mblidhte pak e nga pak, me kursim të përditshëm. Malli e gërryente përditë e më shumë si krimbi drurin e gështenjës. Punonte dhe përsillte pa pushuar thellë nënvetëdijes nënën plakë, pafundësisht e dhembshur, që mbante merakun e tërë botës mbi trupin e imët përkulur nga pleqëria.

Për çdo ditë, pa harruar as edhe një herë të vetme, plaka hidhte vështrimin tutje bregut nga do të vinte i biri. Gjethet e lajthisë çelën në pranverë, u skuqën dhe ranë vjeshtës së vonë. Priste me ankh të bleronin sërish. E ndillte pranverën me zjarrin e shpirtit, dashurinë e pafund të mëmësisë. Vasua e donte sipërisht nënën, edhe fëmijët edhe gruan. E donte jetën, njerëzit, vendin e tij të çërkët plot male dhe gurë.

Ishte ditë shtatori, kur Seti i tha:
- Me Taren vendosëm të kthehem, nuk e shtyjme dot më gjatë këtej.
Vasua u mendua. Pak shpejt për të, duhet të rrinte edhe ca, por rast më të mirë për t' u kthyer me shokë të një sere e gjaku nuk do të gjente. Rrugët e mërgimit janë përherë të pabesa, ndaj vendosi.
- Do të vij me ju, - tha, - kur bëhet mbarë?

- Të hënën ka linjë autobuzi për Shkup, pastaj jemi afër.

U nisën. Vasua me shprehjen lehtësuese nga mërgimi i hidhur mbetur pas, mbaruar me përkushtim dhe zemër të qëruar. Dy të tjerët, me kuleta bosh, e kishin marrë vendimin e kobshëm. Pristin rastin e volitshëm të muzgëtonin krimin makabër. Nuk patën kurajë ta vështronin në sy.

Përgjatë rrugës spërdredhur të kthimit fatal, Vasua mblaçiste kujtimet. Nëna e imët, e dhembshur me një mal dashurie bekonte kthimin e tij si vegim në përgjumjet e udhëtimit, po edhe ditën sy hapur. Çuditërisht një natë i tha në ëndërr:
- Ç' i ke ata ujçer që po të sjellin o bir? Ruaju prej tyre.

U zgjua i tmerruar. Vështri Setin dhe Taren që flinin krah tij. Flinin të shqetësuar, seç murmurisnin nëpër gjumë, po nuk i ngjanë me ujç. Punë ëndrre mendo, plaka gjithnjë ka patur merak. I verbër nga pafajësia.

Në hotelin e ndotur zunë një dhomë të tre. Vendosën plaçat nën kokë. Kuleta lagur me djersën e mërgimit ngjeshur në brezin e Vasos ua bënte me sy mëkatarëve, u jepte forcë të shpinin gjer në fund zhbërjen e mbrapshtë.

- Dalim shprijmë këmbët bregut të lumit, - propozoi Tarja zëngjirur, buzë mbrëmjes së hirtë të Shkupit.

Nuk shikoi asnjërin në sy. Frika e mbështillte në zhguall gjembash, që e shponin ngado. Vasua i mirë, shpirtflori nuk pikasi kobin, sidoqë shenjat

Thirrja e Gjakut

tregim

s' mungonin. Duket se një fat i paracaktuar mbyll gjithnjë shtigjet e dyshimit dhe e çon viktimën drejt fundit.

Mbrëmja e qytetit të madh kotej e përgjumur. Përanë Vardarit të vrullshëm, seicili zvarriste mendimet e veta. Vasua ëndërrimtar me mall të përndezur shihte vatrën e shtëpisë dhe njerëzit e dashur. Vardari rrëshqiste në shtratin zgjeruar betër. Shkumëzuar, i frikshëm ngjante më shtazët mitologjike stërmëdha si punë sprije. Tek vështronte lumin e tallazitur të potershëm i vrundulluan mornica nëpër trup.

Thika e parë u ngul në mes të shpatullave, thellë gjer në dorezën e fildishtë. U kthye rrëmbyeshëm i habitur, murrëtyer nga dhimbja, po thika e dytë hyri me shpejtësi në stomak. Ulëriu i kruspullosur me duart në bark. Gjakun shpërtheu me vërtik i pastër e i pafajshëm. Ende të ngrohtë, pa dhënë frymën e fundit e shtynë dhunshëm në lumë. Vardari e përlau si cingël.

Seti, me kuletën e përgjakur në duar, ktheu sytë përkundër lumit. Shpërthyen të vjellat. Tarja nxirte zorrë në anën tjetër. Në fytyrat e vrasësve, shembëlltyra e të vrarit. Shpirti i sapoçliruar ende kërcënues përreth tyre. I përndoqi pa mbarim gjer në fund të udhëtimit mizor e më përtej. Përpiqeshin t'ia kalonin ngushëllimin njëri - tjetrit, donin të shfaqësonin veten përballë ndërgjegjes së turbulluar. Vasua u kthye në fantazmë tmerruese dhe torturësllëse. Gjumi i tyre u shpërbë se vdekja i tmerrroi, siç nuk e mendonin. Të vdekurit asnjëherë nuk i lenë qetë të gjallët, veçan mëkatarët.

Pak ditë pas kthimit Heisi, përqekur e merakosur, erdhi me një frymë në shtëpinë e Seti.

- Ku është im vëlla, nuk u kthye me ju?

- Jo, - tha Seti, - nuk erdhi me ne.
- Ne e dimë që punonit bashkë, tok ikët e tok duhet të ktheheshit, ç'ka ndodhur? - dyshoi Heisi.

- Nuk po më beson, - ia ktheu Seiti dhe u betua skajërisht rëndë:

"Po të gënjej, pifsha gjakun e fëmijve të mi".

Pastaj me lumë fjalësh zuri t' i mbushte mendjen tjetrit se ishte i pafajshëm. Fliste me gje dhe zë të lartë, po nuk thoshte asgjë në një zhurmëri të heshtur.

Tjetri e besoi, madje i erdhi keq që kishte dyshuar. Kërkoi ndjesë dhe u largua i ligështuar.

Po nënës nuk i lahej zemra, përndjente të ligën e madhe, gjëmën e Vardarit të mallkuar. Natën dhe ditën, njëlloj i rrinte përpara djali i gjakosur. Zërat e të vdekurve flasin për veshët e të gjallëve që tendosen t' i zhbijojnë. Nëna dëgjonte me zemër. Nata e saj u kthye në qëndim të vjetër, grisur dhe pluhurosur, ku koha e plakur s' shihte më dhe shponte duart me gjilpërë.

- Shko të Tarja, - i tha djalit, - pyete më hollësisht.

Tarja e priti me pekule sikur të mos kishte ndodhur asgjë. E dëgjoi, pastaj për të larguar mëdyshjet u betua për ç' kishte më të shtrenjtë. Tjetri përsëri besoi se betimi që tepër i rëndë.

Plaka nuk i vuri gur zemrës, nuk mundej. Më rëndë se vdekja e të birit peshonte dyshimi. Më torturues se të dy që varri i munguar. Ku ta qante djalin e humbur? Dilte tek porta e shtëpisë, vështronte bregun e lajthive dhe vinte kujën ditë për ditë. Brenga e pamatë e çoi shpejt në varr, po kurrë nuk besoi se Vasua humbi. Jo, djalin e vranë ujçit, prandaj amaneti i saj qe mallkim:

"Betimet e ujçve që i copëtuan djalin të ngjizeshin doemos një ditë".

Koha e mbështolli me cipë të hollë transparente zhdukjen e mundimshme, e ktheu në mister. Dalngadalë enigma u zbeh, u fsheh nëpër kohën e ujëshme. Jetimët u mësuan me gjendjen e re, mungesën e dhimbshme të njeriut të dashur. Jeta tërhiqej zvarrë në shtëpinë e Vasos.

Edhe pas dy vitesh nga zhdukja e tij, fajtorët njëlloj përjetonin ditë të hidhura. Vasua mungues, hijerëndë i gjëmshëm, trazonte netët e tyre. Hija e tij përcillte kërcënim, ankh, tmerr. Jeta e vrasësve kishte marrë krisje të honshme, të kobshme.

Grupi i ustallarëve atij moti ndërtonte shtëpinë e rrënuar të Skënderit. Rrërimi pati qenë i dhunshëm, kapërcente përfytyrimin e njerëzve dhe askush nuk e priste. Në mesnatë mali gjëmoi si në lindje të vështirë, u drodh së brendëshmi, pastaj shpërtheu me rrapëllimë gurësh e dherash, përzier me ujrat e turbullta, të rrëmbyera. Duart e vjeshtës së vonë trazuan gjirin e malit, ku qenë mbështetur banesat e vendit. Peisazhi lëvizti gjymtyrët si i paralizuar që fillon të ecë. Njerëzit braktisën strehëzën e vjetër me nxit e rrëmbim nga gurgullimat tmerruese. Së largu vështronin të hutuar groposjen e frikshme të shtëpisë, kasolles, lëmit dhe mullarit me bar përqosh gurit të madh. Lëvizja e çrregullt tronditi hapësirën. Vendi i mëparshëm tani qe bosh si shpellë e frikëshme.

Njerëzit punonin të përqendruar dhe bluanin çuditë e pakuptuara të botës. Ishin lodra në duart e zotit. Asnjëherë nuk dihet ç' sjell rasti. Seti pinte duhan dhe shikonte ustallarët me pamje të vretur. Vardari ia kishte ngrirë tiparet e fytyrës. Kishte frikë nga betimi, jo nga vdekja. Hija e Vasos i qëndronte mbi kokë, pa u larguar asnjëherë, tronditëse dhe kërcënuese. Largësia kohore afronte vrasjen, zbulonte hollësi që nuk i pat menduar në çastin fatal ashtu si distancat hapsinore qartësojnë pamjet e qenieve stërmëdha, të pakuptueshme kur je afër tyre.

Kohët e fundit nuk i ndahej të birit

që punonte me ustallarët. Deni qe djalë i mbarë, punëtor me shpirt të madh dhe i kudogjendur. Seti krenohej me djalin, po në një kënd të shpirtit qe ulur galiç betimi, që i turbullonte shikimin dhe brençonte jetën. Ankthi kapërcente përjetimet e përditëshme, mbyste dritën dhe përthithte errësirën e frikshme.

- Si mund të shlyhet krimi i Vardarit? - bluante me vete ditë për ditë pa pushuar asnjë herë të vetme, pa gjetur asnjëherë përgjigje.

Tarja mbahej më mirë.

- Duhet të mos e mendosh - i thoshte shpesh, - ç' u bë nuk zhbëhet më.

Po Seti nuk e largonte dot pamjen e Vasos me thikat ndërkallur përreth trupit të drobitur. Thika e Tares e plagosi, thika e tij vulosi vdekjen. Sytë e hapur tej mase i rrinin përpara edhe ditën, kurse natën nuk e linin të mbyllte sy.

- Ç'farë kërkon? - pyeti në jerm i trazuar.

- Hiq thikat, kam dy vjet nuk i mbaj dot më, - iu përgjigj Vasua.

Zëri vinte mbytur, i paqartë, tekta figura e turbulluar ndërronte pamje në çdo fjalë. Nganjëherë zhdukej dhe gjallonte vetëm nga tingulli i zërit të çjerrë, kurse në raste të tjera formësohej plotësisht, dyllë i verdhë pa asnjë pikë gjak në shtatin e kruspullosur më dysh si atë ditë pranë lumit.

Seti u përkeq.

- Ah zot si nuk na vajti mendja ta varrosim. Oh i mjeri unë! - rënkoi.

Tjetrit iu dhimbs. Vuri dorën përmbi thikën e stomakut, pastaj tha:

- Atëhere mbaj betimin.

- Po të var veten, të hidhem nga shkëmbi ose në zjarr? - pyeti.

- Thikat ose betimin, - këmbënguli hija e mjegulluar.

Edhe e shikonte edhe jo. Herë trupëzohej dhe dukej qartë, pastaj turbullohej, vinte rreth, pa i ndarë shikimin e nemitur. Seti e ndiqte me sy, nuk lëvizte dot dhe rënkonte i terrorizuar. U ngrit mundimshëm, ngadalë. Vendosi litarin në degën e mollës së oborrit, hipi mbi një palë shkallë dyshe, që prisnin drutë. Vendosi hallkën në qafë dhe shtyu me këmbë shkallaren. Litari e shtrëngoi fort dhe fryma po i mbahej, po ai u ndje i lehtësuar, iu dorëzua vdekjes ëmbëlçake i lumtur. I vetmi shpëtim nga makthi i vazhduar për dy vjet stërgjatur pa mbarim. Në lëkundjen e dytë e priti Deni, preu litarin dhe e mori të alivanosur në krahë. Kur erdhi në vete nuk kuptonte ç' kishte ngjarë. Bisedoi si çdo natë me Vason, më tej nuk kujtonte asgjë. Një muaj përumbi në jerm, fliste përçart dhe bënte shenja misterioze. Seç bisedonte me një hije të padukshme që nuk i përmendte asnjëherë emrin.

Tretur, kockë e lëkurë doli nëpër fshat. Ndiqte pas të birin, pa asnjë shprehje në fytyrën e ngurtësuar, që nuk përthente asgjë, nuk ndjente asgjë. Nuk mund të qante, as të qeshte, vetëm vështronte i menduar e brenguar pa fund.

Rrëshqitja e malit nuk i bëri përshpëtyrje, e përcolli pa ndonjë përjetim të dukshëm. I vetmi ndryshim në ditën e tij ishte rruga për te shtëpia e Skënderit ku punonte Deni. Me sytë pa shprehje si kufomë vështronte djalin, që punonte vrullshëm dhe herë pas here hidhte vështrimin nga i ati.

Seti kotej i përgjumur. Kur u përkul mbi gjunjë në dremtitjen e gjatë, djali u drodh dhe nxitoi t' i vinte në ndihmë. Në kthimin e vërtikshëm humbi drejtpeshimin dhe ra nga skela. U gremis mbi gurin mprehtë të veglave që i ndau gjoksit më dysh. Gjakun shpërtheu me forcë.

Burri u zgjua nga thirrërnaja, pa pikë gjaku në deje. Me hap të ngadalshëm iu afrua të birit që po jepte shpirt. E priste prej kohësh, madje u vonua shumë. Të tjerët i hapën udhë lemerisur nga vdekja e djalit, po sidomos qetësia e kobshme e të atit. Seti u përkul pranë trupit të djalit, futi qetësisht duart në gjoksit e çarë, të përcuduar, mbushi grushtin me gjak. E piu gjer në pikën e fundit, pastaj u largua me hap të ngadalshëm pa kthyer kokën në një ikje të kobshme.

Dhjetor 2008

MIRATOHET HAPJA E FAKULTETIT EKONOMIK NË POGRADEC

Një vendim i Këshillit Bashkiak të Pogradecit, i marrë në mbledhjen e tij të fundit në muajin shkurt 2009, i çeli rrugën hapjes në këtë qytet të fillit të Universitetit të Korçës për Fakultetin Ekonomik, dega turizmit. Për herë të parë, ky fillial do t' i çelë dyert në shtatorin e këtij viti. Deri atëhere Bashkia do të ketë marrë masat dhe do të bëjë të gjitha përgatitjet për të gjetur vendin dhe për ta pajisur atë me gjithçka që nevojitet. Lajmi konfirmohet nga Bashkia e Pogradecit, por edhe nga Rektori i Universitetit "Fan Noli", në Korçë Gjergji Mero. Ka qenë senati akademik i Universitetit të Korçës që në janar të këtij viti i ka drejtuar kërkesën për çeljen e këtij filliali Këshillit Bashkiak të Pogradecit. Këshillit Bashkiak i Pogradecit, në mbledhjen e tij e diskutoi këtë propozim. Së bashku me këshilltarët në këtë mbledhje kanë qënë edhe drejtues të Universitetit të Korçës të cilët bënë prezantimin e projekt-idesë së tyre, që gjeti mbështetjen e të gjithë këshilltarëve. Pas vendimit të senatit dhe të Këshillit Bashkiak pritet miratimi edhe nga Dikasteri përkatës Ministria e Arsimit. Palët kanë rënë dakord që Bashkia të sigurojë mjedisin ku do të çelet filliali, ndërsa Universiteti i Korçës do të sigurojë stafin akademik dhe do ta pajisë atë me bazën materiale, laboratore e mjete të tjera mësimore.

DOKUMENTET PËR MARRJEN E AKTIT TË RI TË PRONËSISË PËR TOKËN BUJQËSORE

Nga Zabit CUKU

Qeveria miraton procedurat e krijimit të akteve të reja të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si rezultat i korigjimeve. Vendimi i përgatitur në Zyrat e Kryeministrit dhe i miratuar më datën 18 shkurt 2009, paraqet pikërisht procedurën e korigjimit të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe formularin tip të këtij akti, që do të lëshohet në katër kopjo, konkretisht:

a (Pronarit)
b (Seksionit të Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës)
c (Komisionit vendor)
ç (Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme. Sipas vendimit të përgatitur qytetarët duhen të parqesin pranë komisionit vendor.

a (Kërkesën për korigjimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi;
b (certifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e komunës dhe/ose bashkisë ku të pasyrohet numri i antarëve të familjes bujqësore ose individit në favor të të cilit do të lëshohet akti i ri i marrjes së tokës në pronësi;

c (aktin e marrjes së tokës në pronësi, në origjinal, së bashku me planvendosjen e ngastërs/ngastrave, të konfirmuara nga kryetari komunës ;
c (plan vendosjen e ngastërs/ngastrave, nga qytetari, sipas informacionit që ka, pretendon se është, hartuar sipas harytës treguese të regjistrimit në shkallën 1:2500, nga një specialist topograf i licencuar;

d (vërtetimin e faktit se ka qënë ish antar i ish kooperativës bujqësore më 1.8.1991. ose punonjës i ish ndërmarrjes bujqësore, më 1.10.1992. Për këtë arsye qytetari duhet të depozitojë shkresën nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për pagesën ose jo të pensionit, si konfirmimin cilido qoftë ai, të keytarit të komunës, për këtë fakt. Nëse sipas informacioneve sa më sipër nuk vërtetohet fakti i të qenit antar i ish kooperaivaës bujqësore ose ish punonjës i ish ndërmarrjes Bujqësore, qytetari ka të drejtë të depozitojë pranë komisionit vendor, çdo dokument që

vëteton faktin e mësipërm. Pas depozitimit të dokumentacioneve në vendimin e qeverisë paraqiten detyrat që do të kene më pas komisionet vendore e konkretisht, konsperodeca e detyrueshme e komisionit vendor me institucionet, veprimtaritë të cilave lidhet me lëshimin e "Aktit të ri të marrjes së tokës në pronësi", siç janë komunat/bashkitë, zyrat e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Pas këtij procesi, Komisioni Vendor plotëson në katër kopjo origjinale aktin e ri të marrjes së tokës në pronësi. Ky akt shoqërohet edhe me planvendosjen e ngastërs/ngastrave. Më pas, komisioni vendor dërgon në seksionin e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës autorizimin dhe kopjon origjinale të këtij vendimi, për lëshimin e aktit të ri të pronësisë, bashkë me fotokopjon e dokumentacionit të ri ligjor.

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në bazë të vendimit dhe dokumentacionit që disponon nga Komisioni vendor, kontrollon aktin e ri të marrjes së tokës në pronësi dhe planvendosjen përkatëse të ngastërs/ngastrave dhe kur i gjen ato në përputhje me kërkesat e ligjit" Për verifikimin e titujve të Pronësisë", i miraton ato. Akti i ri i marrjes së tokës në pronësi dhe planvendosja nënshkruhen nga përgjegjisi i seksionit të administrimit të dhe mbi nënshkrim vendoset vula e këshillit të qarkut. Korigjimi i akteve të pronësisë vjen si domodoshmëri e zbatimit të një prej neneve të ligjit për verifikimin e titujve, ku thuhet se, komisionet vendore janë të detyruara që të shqyrtojnë kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga qytetarët dhe institucionet shtetërore. Vendimi sa më sipër, në fakt është një hap para zbatimit të ligjit për titujt, ndërkohë që vetë zbatimi i këtij ligji ka sjellë mjaft probleme.

OBORRET E SHTËPIVE QË I KANË NË PËRDORIM, MUND TË BËHEN PRONËSI

Të gjithë ata individë që jetojnë në fshat ose në qytet, dhe që oborret e shtëpive të tyre i kanë në përdorim dhe jo në pronësi mund të bëhen përfundimisht pronë e



TABELA E LLOGARITJEVE

*Për sipërfaqet nga 100 m2 do të paguhen 200 mijë lekë të rinj.
*Për sipërfaqet nga 101 m2 deri në 200 m2 do të paguhen 200 mijë lekë të rinj.
*Për sipërfaqet nga 201 m2 deri në 300 m2 do të paguhen 400 mijë lekë të rinj.
*Për sipërfaqet nga 301 m2 deri në 400 m2 do të paguhen 500 mijë lekë të rinj.
*Për sipërfaqet nga 401 m2 deri në 500 m2 do të paguhen 500 mijë lekë të rinj.

tyre. Qeveria ka miratuar më 19 shkurt 2009 vendimin që i hap rrugë ligjore tjetërsimit të pronësisë për të gjithë ato sipërfaqe trojesh që janë në pronësi të shtetit, mbi të cilat janë ngritur ndërtesat të ligjshme para muajt gusht 1991.

Për këtë bëhet kërkesa.

Me marrjen e kërkesës zyra rajonale e AKKP-së shqyrton kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të saj. Ajo verifikon dhe pohon nëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar përbushin kushtet e përcaktuara, si dhe sak-

tëson kufijtë e oborrit në përdorim, që kërkohet të tjetërsohet. Në përfundim, zyra qëndrore njofton kërkuesin për të drejtën e tjetërsimit me shpërblim dhe detyrim për të paguar brenda 30 ditëve, për llogari të AKKP-së, për fenomenin e kompesimit financiar, çimin e tjetërsimit duke i treguar dhe numrin e llogarisë. Ky njoftim përmban një paraqitje të kufijve të sipërfaqes në m2 dhe të vendndodhjes së oborrit në përdorim, të shoqëruar me planimetritë përkatëse. Në këtë rast, qeveria ka vendosur të përdorë tarifa që paguajnë edhe personat që kanë ndërtnuar në mënyrë të paligjshme dhe që janë objekt i ligjit të legalizimeve të ndërtimeve pa leje. Kështu kërkuesi do të paguaj tarifë fikse, që variojnë nga 200 mijë, deri në 600 mijë lekë të rinj, kjo në vartësi të sipërfaqes që ze oborri që do të privatizohet. PAGESA bëhet jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit prej AKKP-së. Tjetërsimi i pronësisë bëhet edhe pa shpërblim, në rast se shtetëzimi i saj sipërfaqe ka qënë bërë më parë nga shteti pa vlerë monetare.

QYLAËT E BARDHË

Qulahët e bardhë dhe festja e kuqe, janë një grup karakteristik i kokëmbajtësve shqiptarë, që importoheshin edhe nga jashtë me shumicë, në shekullin XVIII-XIX. Qylahët përdorëshin për shtresat e gjera të popullsisë, veçanërisht ato me ngjyrë të bardhë. Ndërsa fesat e kuqe ishin prej cohe me lartësi të ndryshme, në majë të së cilave kishte një trufë mëndafshi të zi ose blu. Fesin e kuqe e mbanin zakonisht burrat e shtresave të pasura dhe janë shumë të hershme në shqipëri. Georg Han në veprën e tij "Studime shqiptare" vëren se në vitin 1866, duke kaluar nëpër luginën e Drinit dhe në karra, pa burra me kësula dhe kapuçi leshi me ngjyrë të bardhë dhe të hirtë. Në këto zona edhe fesi i kuq i prodhuar në Evropë, përdorej edhe kjo spegohej me cilësinë e lartë të leshit dhe bukurinë e tyre. Shpesh festat dhe qulahët mbështilleshin me copa dhe rrypa lëkure, që mbulonin edhe veshët dhe vendoseshin vertikalisht. Është me vend që të përmendim kokëmbajtje popullore edhe kapelen e lartë shqiptare me strehe, ose kokëmbajtje shpatarake, të vizatuar nga piktori i madh shqiptar Onufri, në shekullin XVI, me ngjyrë të bardhë. Zakonisht këto piktura gjenden në pikturat me ngjyra të Onufrit në Kishën e Shën mērisë, në Vllahernë në Berat dhe në kishën e Valshtit e Shelcanit, në Shpat të Elbasanit. Kjo lloj kapele mbahej shumë nga barinjët shpatarakë. Kostumi popullor Shpatark me kapelen e lartë shqiptare me strehë do të perbejnë suprizën e asambli folklorik të qarkut të Elbasanit në festivalin Folklorik Kombëtar të këtij viti në Gjirokastrë. Kokëmbajtëset shpatarake si dhe kostumet e reja popullore të zbuluara në baulet e asambleve shqiptare të Elbasanit, do të kalojnë këtë vit në paradën e festivalit. Jo vetëm në festivale flokue, por edhe në koncerte popullore, është mirë që kokëmbajtësja të mos hiqet nga koka, spse ndryshe e shëmtton kostumin popullor .

Është një shembull i math që 170 vjet më parë, bamirësi shqiptar Vangjel Zhapa nga Labova e Odrjës së Gjirokastrës, në çifligun e vet në Broshtetin të Rumanisë mbante 100 punëtorë shqiptarë, që shërbenin, të veshur me kostumin popullor të jugut, me fustanellë dhe fesat e kuqe. Zhvillimi i turizmit kulturor në Shqipëri kërkon ringritjen e artizanatit shqiptar me zanatet e tij karakteristike, i cili do të çojë në ripërtitjen e kostumeve të traditës popullore, siç punon në Tiranë mjeshtri artizan Egerem Erebara. Pa dyshim për kokëmbajtëset popullore shqiptare është një sensibilizim për institucionet përkatëse, të cilët duhet të mendojnë projekte konkrete për nxitjen e riprodhimit të tyre dhe organizimit të ekspeditave shkencore për zbulimin dhe gjetjen e origjinaleve të tyre. Kokëmbajtësja shqiptare është bukuria e kostumit popullor.

Etnolog, Thanasi MEKSI

POSTIERËT E SLABINJËS SHËRBYEN ME DASHURI

Korierët kanë qënë në çdo fshat që në kohën e Zogut, dhe quheshin pojakë. Ata zbatonin detyrat që u ngarkonte kryeplaku i fshatit me pleqësinë. Në kohën e Zogut, në fshatin Slabinjë korier ka qënë Hasan Balliu, ishte një burrë korrekt, dhe i urtë. Pas çlirimit ka qënë Qamil Kullolli, pas këtij ka qënë korier Bannush Balliu. Ai ishte i shpejtë, dhe kur thërriste ai dëgjohej në fshatin Hoshtëçë. Në vitet 1960-të, pas këtij vjen korier Ibrahim Braçe, i cili kishte zë shumë të qartë, shumë i thjeshtë, vinte shtëpi më shtëpi dhe sillte letrat, gazetat, revistat, dhe çdo gjë e çdo lloji porosie që kishte.

Pas këtij në vitin 1970-të, u vu në detyrën e korierit të fshatit Zyber Bego, një burrë shumë i lartë, dhe puntorë. Edhe pse kishte aftësi të kufizuara, me një dorë, që e kishte dëmtuar gjatë luftës në vitin 1941, ai shërbente më gjithë zemër. Zyber Bego e vazhdoi detyrën deri në prishjen e sistemit komunist në vitin 1992.

Shtypi i përditshëm merrej çdo ditë në Proprië dhe shpërndahej në tërë fshatin. Në Proprië ishte një postë. Ajo ishte rregullatori i Mokës së Poshtme. Çdo gjë ishte e organizuar



dhe, korespondenca e letrave, telegrameve, gazetave, ishte e sigurtë banorët abonoheshin në gazetata dhe revistat, ato vinin në çdo fshat. Në fshat dëgjohej një zë se erdhi posta, erdhi posta! Lajmëtarit ishte postieri. Kjo ndodhte në çdo fshat. Sa sakrificë e madhe! Një shërbim i tillë e ka bërë postierët e Slabinjës. Në shi, në dëborë, ata shkolin në Proprië. Ishin ata që sillnin habere, për të mirë apo për të keq. Ata dalloheshin për lajmin që të jepnin për të mirë e për të keq .

Zyber mbante një çantë në krah, shkopin në dorë. Rrugën për në Proprië e bënte çdo ditë, në dimër dhe në verë, me çantën e mbushur me letra dhe me gazeta.

Vështire e kishte postieri në dimër, kur kishte dëborë, natën pa ndriçim por mbantë fenerë me vajguri në dorë.

Ky shkrim tregon për sakrificën e këtyre postierëve të nderuar dhe vlerësimin e lartë, përkushtimin e tyre për të shërbyer popullit .

Ata shërbeyen me përkushtim, për t'u çuar banorëve të tyre kulturën, informacionin, njohuri për të mësuar diçka nga jeta dhe jashtë saj.

Islam FERO